



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 45/2021 regjistër (JR)
Datë 16.08.2021

Nr. 29 i vendimit
Datë 13.07.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulja	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 13.07.2023, ditën e enjte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Agim Dalipaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 402, datë 17.06.2021.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, Dh, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim si dhe parashtrimet para seancës, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Agim Dalipaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës, të miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, mbante detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe, për shkak të këtij funksioni, në zbatim të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex-officio*.

2. Për subjektin e rivlerësimit Agim Dalipaj, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) është kryer hetimi administrativ për të tria kriteret e vlerësimit, përkatësisht për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

2.1 Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave¹ (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;
- nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- ka kryer fshehje të pasurie;
- ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. DSIK-ja dërgoi një raport të arsyetuar² pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, nëpërmjet të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Agim Dalipaj.

2.3 Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi,

¹ Të përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 20.12.2018.

² Të përcjellë me shkresën me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 2.11.2017, të deklasifikuar me vendimin nr. {***}, datë 26.05.2021, të KDZh-së.

sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin nr. 402, datë 17.06.2021, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Agim Dalipaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.*
4. Vendimi për subjektin e rivlerësimit Agim Dalipaj, është marrë nga Komisioni bazuar në problematikat e hasura në kriteret e vlerësimit të pasurisë dhe të aftësive profesionale, ndërsa nuk ka gjetur problematika në kriterin e kontrollit të figurës, duke konkluduar si vijon.

a) Për kriterin e kontrollit të pasurisë: *i. subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016; ii. subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshme blerjen e pasurisë apartament në njësinë administrative Shëngjin, si dhe mobilimin e apartamentit në qytetin e Lezhës, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016; iii. subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit, në kuptim të germës “d” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Agim Dalipaj ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimit të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

b) Për kontrollin e figurës dhe cenimin e besimit të publikut: *Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe vlerësimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se subjekti ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit Agim Dalipaj ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*

c) Për vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni ka konkluduar: *Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme, dosjeve të administruara nga Komisioni dhe denoncimeve të depozituara, trupi gjykues konstaton gabime thelbësore dhe serioze, si dhe ekzistencën e një serie të qartë dhe të vazhdueshme të gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale të subjektit. Ai ka treguar cilësi të papranueshme në punë dhe gjykim të dobët, që çojnë në cenim të të drejtave të palëve. Subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit.*

Të gjitha këto të meta të konstatuara në vlerësimin profesional të subjektit, vlerësohet se cenojnë besimin e publikut të një magjistrat.

³ Të përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 16.01.2019.

Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, në atë shkallë sa programi i trajnimit në Shkollën e Magjistraturës nuk mund ta zgjidhë këtë çështje për një vit.

Në vlerësimin tërësor të procedurave lidhur me cenimin e besimit të publikut, duke vlerësuar në tërësi kriterin e pasurisë dhe atë profesional për subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, rezultojnë disa rrethana, të cilat, të analizuar së bashku e të para në harmoni me njëra-tjetrën, tregojnë për një sjellje të subjektit të rivlerësimit në raport me detyrën, e cila do të ishte e papranueshme për të pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe te roli i subjektit, si një funksionar i denjë i atij sistemi. Në këto rrethana, përfshihen problematika e konstatuar në drejtim të kontrollit të kriterit të pasurisë në lidhje me situatën e konfliktit të interesit, si dhe sjellja e subjektit në drejtim të trajtimit të çështjeve penale që lidhen me hetimin e veprave penale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë, të cilat kanë sjellë si pasojë humbjen e jetës së qytetarëve ose dëmtimin e rëndë të tyre.

Mënyra e veprimit të subjektit, si për përfitimin e pasurisë në kushtet e konfliktit të interesit, ashtu edhe paaftësia në kryerjen e procedurave hetimore, do të lexohet nga publiku si një sjellje që nuk ngjall besim te sistemi i drejtësisë.

III. Shkaqet e ankimit

5. Subjekti i rivlerësimit Agim Dalipaj ka ushtruar ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 402, datë 17.06.2021, me anë të të cilit ka pretenduar për cenim të parimeve të procesit të rregullt ligjor, ka kundërshtuar konkluzionet e Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, si dhe qëndrimet për cenimin e besimit të publikut.
6. Me ankimin, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”):
 - a) *Prishjen e vendimit nr. 402, datë 17.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjykimin e çështjes në themel nga KPA dhe në përfundim të gjykimin, konfirmimin në detyrë; ose:*
 - b) *Ndryshimin e vendimit nr. 402, datë 17.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin tim në detyrë.*

A. Shkaqe të ankimit lidhur me procesin e rregullt ligjor

7. Në drejtim të zbatimit të parimeve të procesit të rregullt, si dhe të procedurave ligjore të nevojshme, subjekti i rivlerësimit pretendon se: (i) nga mënyra se si është zhvilluar procesi i tij i rivlerësimit në Komision, duket se ky organ nuk ka mundur të ruajë paanësinë dhe pavarësinë e tij, por ka dhënë një vendim të paracaktuar, duke mos bërë një analizë të provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. Analizat dhe interpretimet e kryera nga ana e Komisionit për kriterin e pasurisë, janë në shumë raste jo objektive, paragjyqese e në interpretim të gabuar të frymës dhe qëllimeve të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve; (ii) Komisioni, çështjen e tij të rivlerësimit kalimtar, e ka trajtuar në mënyrë diskriminuese dhe ka bërë një interpretim të ndryshëm të ligjit dhe një vlerësim të ndryshëm të fakteve në raport me vlerësimet që ky organ ka bërë në rastet e shumë subjekteve të tjera; (iii) Komisioni i ka mohuar të drejtën për t’u dëgjuar, duke pretenduar se në mënyrë sistematike gjatë hetimit administrativ, nuk i ka dhënë lehtësitë e nevojshme kohore për të realizuar mbrojtje efektive dhe nuk ka “dëgjuar” një pjesë të madhe të provave dhe argumenteve të paraqitura nga subjekti; (iv) vendimi është i

paarsyetuar, duke shkelur në këtë mënyrë një element të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor duke mos plotësuar standardet e arsytimit të vendimit, të përcaktuara si të tilla nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese; (v) Komisioni, në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk ka konsideruar se ligjvënësi ka vendosur që gjatë rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sanksionojë standardin e moslejimit të justifikimit më shumë se të dyfishit të pasurisë së të ardhurave të ligjshme të dokumentuara.

B. Shkaqe të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

Subjekti i rivlerësimit pretendon se, për pasurinë apartament banimi, të përfituar për shkak të pasjes së statusit “i pastrehë” nga Enti Kombëtar i Banesave (në vijim “EKB”), me sip. 89 m², konkluzionet e vendimit të Komisionit se subjekti ka qenë kontradiktor lidhur me kohën e fillimit të jetesës në këtë apartament dhe nuk ka pasur burime të ligjshme për mobilimin e këtij apartamenti, në shumën (-) 409.442 lekë në muajin mars të vitit 2006, që konsiderohet momenti kur ka filluar të banojë në këtë apartament, nuk janë të drejta dhe të bazuara.

8. Për pasurinë apartament me sip. 53 m², në qytetin e Shëngjinit, ndërtuar në vitin 2006, të blerë nga shoqëria “{***}” ShPK, me vlerë 21.500 euro, subjekti i rivlerësimit i konsideron si jo të drejta e të sakta e në përputhje me shpjegimet e tij, konkluzionet e Komisionit se: **(i)** Nuk ka justifikuar me burime të ligjshme financimin e blerjes së kësaj pasurie. **(ii)** Këtë pasuri nuk e ka deklaruar në mënyrë të plotë dhe të saktë në deklaratën *vetting*, për sa i përket vitit të krijimit dhe burimeve të financimit të saj. **(iii)** Në kushtet kur subjekti në vitin 2002, ka hetuar çështjen penale me të pandehur z. L. Rr., ndërkohë që: (a) kishte porositur një apartament te shoqëria në të cilën z. L. Rr. ishte ortak i vetëm; (b) kishte marrëdhënie shoqërore me këtë shtetas; si dhe (c) sipas pretendimeve të tij, i kishte dhënë hua një shumë të konsiderueshme z. Rr. – ai ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, bazuar në nenet 17/1 dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale.
9. Subjekti i rivlerësimit konsideron si jo të drejtë dhe të saktë analizën që Komisioni ka kryer në funksion të verifikimit të mundësisë së subjektit të rivlerësimit për të krijuar me burime të ligjshme fondet e përdorura për krijimin e depozitës në vlerën 1.000.000 lekë në Raiffesisen Bank, të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*.

C. Shkaqe të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe cenimin e besimit të publikut

10. Subjekti i rivlerësimit kundërshton dhe konsideron si jo të drejta dhe të bazuara në ligj konkluzionet e Komisionit lidhur me: **(i)** vendimin e pushimit të hetimeve të procedimit penal nr. {***}, të vitit 2016, për veprën penale “Shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetases Z. I.; **(ii)** kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. {***}, të vitit 2015, në ngarkim të shtetasit Q. B.; dhe **(iii)** kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. {***}, të vitit 2013, në ngarkim të shtetasit P. D..
11. Subjekti i rivlerësimit pretendon se janë jo të drejta dhe të bazuara ligjërisht konkluzionet e Komisionit që kanë të bëjnë me analizimin e dosjeve penale të zgjedhura me short si vijon: **(i)** vendimin, datë 26.01.2015, “Për pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. {***}, të vitit 2014, për veprat penale “Mashttrim” dhe “Shpërdorim detyre”, për të cilat ka paraqitur kallëzim shtetasi S. A.; dhe **(ii)** vendimin, datë 27.01.2016, “Për pushimin e procedimit penal nr. {***},

të vitit 2015, për veprën penale “Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, të parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve A. H., E. M. dhe F. L..

12. Subjekti i rivlerësimit gjithashtu kundërshton si të pabazuara dhe jo të drejta edhe konkluzionet e Komisionit mbi analizën e çështjeve të tërhequra nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore Tropojë dhe Lezhë, në të cilat është vendosur pushimi i procedimeve penale për veprën penale “Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal, që u përkasin procedimeve si vijon: **(i)** procedimi penal nr. {***}, në ngarkim të shtetasve F. H., me palë të dëmtuar shtetasin N. M.; **(ii)** procedimi penal nr. {***}, me të dëmtuar shtetasin P. N.; **(iii)** procedimi penal nr. {***}, në ngarkim të shoqërisë ndërtuese të HEC-it të {***}-ut.
13. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si jo të drejta e të bazuara në ligj edhe konkluzionet e Komisionit për denoncimin e paraqitur nga L. P..
14. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si jo të drejta e të bazuara në ligj edhe konkluzionet e Komisionit se në vlerësimin tërësor të procedurave duke vlerësuar në tërësi kriterin e pasurisë dhe atë profesional në kuptim të nenit 4 pika 2 e ligji nr. 84/2016 është arritur në përfundimin se ai ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

15. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në gjykim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit Agim Dalipaj, nëpërmjet shkarkimit të tij, përfshihet në juridiksionin e Kolegjit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

16. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

17. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi.

Me ankimin, subjekti i rivlerësimit pretendon se gjendet në kushtet e parashikuara në pikat “b” dhe “c” të nenit 51 të ligjit 49/2012 dhe, për pasojë, kërkon shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.

17.1. Trupi gjykues konstatoi nga analizimi i kësaj kërkesë se ajo nuk shoqërohet konkretisht me specifikimin apo parashtrimin e situatave që do e vendosnin procesin e zhvilluar në Komision nën parashikimet e ndonjë prej situatave të parashikuara prej nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim “ligji nr. 49/2012”). Pretendimet e subjektit janë të përgjithshme dhe të integruara me shkaqet e tjera të ankimit me natyrë procedurale dhe, si të tilla, nuk vlerësohen se prezantojnë ndonjë element relevant me parashikimin e kësaj dispozite. Gjithashtu, subjekti nuk ka paraqitur akte të reja bashkëlidhur ankimit tij, të cilat mund të vlerësoheshin në raport me nenet 47 të ligjit nr. 49/2012 e 49 të ligjit nr. 84/2016 nëse mund të provokonin nevojën për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike. Për pasojë, trupi gjykues vendosi të vijojë ta shqyrtojë çështjen në formën e gjykimit të zhvilluar në dhomë këshillimi, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Vlerësimi i trupi gjykues për shkaqet e ankimit

I. Shkaqe lidhur me pretendimet për cenim të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit

18. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me zbatimin e parimeve të procesit të rregullt ligjor, si dhe të procedurave të nevojshme për t’u kryer nga Komisioni përgjatë procesit të tij të rivlerësimit.

18.1 Lidhur me pretendimet *për paanësi të trupës gjykuese të Komisionit*, konstatohet se ato i referohen si mënyrës së përzgjedhjes të komisionerëve të këtij organi, e cila sipas subjektit të rivlerësimit nuk mundëson pavarësinë e tyre nga politika, si dhe faktit që Komisioni është organi që kryen si hetimin administrativ, edhe merr vendimin përfundimtar, pra gjykon çështjen. Trupi gjykues, në analizë të këtij pretendimi, sjell në vëmendje se kjo çështje e cila është ngritur përgjithësisht në të gjitha ankimet e subjekteve të rivlerësimit, është trajtuar në mënyrë shteruese nga GjEDNj-ja në çështjen *A. Xhoxhaj vs Shqipërisë⁴*, si gjykata e cila kontrollon në nivelin më

⁴ Në vendimin e GjEDNj-së në çështjen *A. Xhoxhaj vs Shqipërisë*, në paragrafët 284, 286 dhe 288, lidhur me funksionet e Komisionit dhe Kolegjit, konkludohet sa vijon: “284. Krijimi dhe funksionimi i Komisionit dhe Kolegjit janë parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës, plotësuar më tej nga nenet C dhe F të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, të miratuar nga Parlamenti. Sipas mendimit të gjykatës, ato ofrojnë një bazë ligjore mjaft të qartë për krijimin e organeve të rivlerësimit, përgjegjëse për kryerjen e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, prokurorëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë (shih paragrafët 103, 106, 112 dhe 122-128 më lart). Fakti se organet e rivlerësimit u krijuan vetëm me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar, u parashtrua edhe në vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafin 169 më lart). Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se, për qëllimet e nenit 6/1, një gjykatë nuk ka nevojë të jetë një gjykatë e integruar brenda mekanizmit standard gjyqësor. Ajo mund të krijohet për të shqyrtuar një çështje specifike, e cila mund të administrohet në mënyrë të përshtatshme jashtë sistemit të zakonshëm të gjykatës (shih Mutu dhe Pechstein, cituar më lart, paragrafi 139) [...]. 286. Në çështjen në fjalë, trupat gjykuese të Komisionit dhe Kolegjit u krijuan në përputhje me ligjin, domethënë më anë shortimi. Kërkesja nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë specifike në lidhje me procedurën e formimit të trupave gjykuese. Pas shqyrtimit të të gjitha çështjeve të faktit dhe ligjit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi për çështjen e kërkujeses. Në shkallën e dytë, atë të apelimit, Kolegji shqyrtoi shkaqet e ankimit të paraqitura nga kërkesja dhe kishte juridiksion të plotë mbi çështjet e fakteve dhe ligjit [...]. 288. Në këto rrethana, gjykata arrin në përfundimin se, duke pasur parasysh faktin se si Komisioni, ashtu dhe Kolegji ishin krijuar dhe formuar në një mënyrë legjitime duke përmbushur kërkesat e një “gjykate të krijuar me ligj”, kërkesja i ishte adresuar “Gjykatës”, sipas kuptimit të kushtit të parë të testit Vilho Eskelinen. Për këtë arsye, neni 6/1 i Konventës gjen zbatim nën aspektin civil të saj”.

të lartë zbatimin e rregullave që garantojnë procesin e rregullt, edhe në kuptim të parimit të gjykatës së formuar me ligj. Sipas kësaj jurisprudence, nuk është gjetur shkelje e nenit 6 të KEDNj-së për shkak të procedurës së zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit dhe as funksioneve procedurale hetimore e vlerësuese që ai kryen. Në këtë kuptim, trupi gjykues e gjen të panevojshëm ta elaborojë më tej këtë shkak, duke e konsideruar të ezauruar në qëndrimin e mbajtur si më lart.

18.2. Lidhur me pretendimin se *analizat dhe interpretimet e kryera nga ana e Komisionit për kriterin e pasurisë janë në shumë raste jo objektive, paragjyqese e në interpretim të gabuar të frymës dhe qëllimeve të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve*, konstatohet se subjekti i rivlerësimit e ngre atë në këndvështrim të faktit që Komisioni nuk ka konsideruar se ka kaluar një kohë e gjatë nga momenti i krijimit të pasurive dhe se, sipas nenit 33 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), i gjithë dokumentacioni që ka të bëjë me kontrollin dhe deklarimin e pasurive i administruar nga ILDKPKI-ja, arkivohet sipas rregullave dhe ruhet vetëm për një periudhë 10-vjeçare. Sipas subjektit, ngarkimi i tij me barrën e provës për të paraqitur dokumentacion justifikues për burimet e krijimit të pasurive që i përkasin një kohe të largët, është një kërkesë jo objektive dhe që cenon parimin e sigurisë juridike.

18.3. Trupi gjykues vlerëson se referimi te neni 33 i ligjit nr. 9049/2003 do të mund të pranohej nëse do të gjendeshim para situatës kur subjekti, në funksion të kontrollit periodik, si subjekt deklarues, kishte paraqitur dokumentacion justifikues pranë ILDKPKI-së, dhe ky organ nuk do t’ia kishte vënë në dispozicion Komisionit, me arsyetimin se sipas kësaj dispozite, ky dokumentacion nuk gjendej pasi ishte paraqitur para 10 vitesh e, si i tillë, nuk ishte ruajtur. Në rastin objekt shqyrtimi, nuk ka rezultuar një situatë e tillë, që ILDKPKI-ja të mos ketë vënë në dispozicion të organeve të rivlerësimit dokumentacion, me arsyetimin se gjendet në kushtet e nenit 33 të ligjit nr. 9049/2003. Për pasojë, pretendimi i subjektit për zbatimin e parashikimit të nenit 33 të ligjit nr. 9049/2003, gjendet i pambështetur në situatën faktike dhe i pabazuar, duke ardhur gjithashtu në kundërshtim me parashikimin e nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit barrën e provës në këtë proces e ka subjekti i rivlerësimit.

18.4 Lidhur me pretendimin e subjektit se *Komisioni çështjen e tij të rivlerësimit kalimtar e ka trajtuar në mënyrë diskriminuese, duke pretenduar se lidhur me të, Komisioni ka bërë një interpretim të ndryshëm të ligjit dhe një çmim të ndryshëm të fakteve në raport me vlerësimet që ky organ ka bërë në rastet e shumë subjekteve të tjera të rivlerësimit*, konstatohet se subjekti nuk referon në ndonjë situatë konkrete të procesit të tij të rivlerësimit kalimtar, e cila të mund të merret në analizë. Në të tilla kushte, ai mbetet një pretendim thjesht teorik dhe i përgjithshëm dhe e vë trupin gjykues në pamundësi për ta vlerësuar atë objektivisht.

18.5 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *Komisioni i ka mohuar të drejtën për t’u dëgjuar, duke pretenduar se në mënyrë sistematike gjatë hetimit administrativ, nuk i ka dhënë lehtësitë e nevojshme kohore për të realizuar mbrojtje efektive dhe nuk ka “dëgjuar” një pjesë të madhe të provave dhe argumenteve të paraqitura nga subjekti*, trupi gjykues, nga të dhënat e fashikullit administrativ, konstaton se Komisioni i ka përcjellë atij katër pyetësorë dhe ka komunikuar në mënyrë të vazhdueshme përgjatë hetimit administrativ. Gjithashtu, nga fashikulli, rezulton se pasi Komisioni i ka përcjellë subjektit të rivlerësimit rezultatet paraprake

të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar kohë shtesë për t'u përgjigjur, kjo kërkesë është pranuar nga Komisioni, veprim i cili ka gjetur pasqyrim edhe në vendim⁵. Për sa i përket pretendimit që lidhet me mundësinë për t'u shpjeguar e dëgjuar lidhur me çështjet për të cilat Komisioni i ka kaluar barrë prove, nga analizimi i procesverbalit të seancës dëgjimore të administruar në fashikullin e hetimit administrativ, konstatohet se gjatë kësaj seance, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të hollësishme lidhur me pasurinë që ai disponon dhe me vlerësimin e aftësive profesionale. Nisur nga kjo situatë faktike, trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit se nuk i është lënë kohë e mjaftueshme në dispozicion për të dhënë shpjegimet e tij, rezulton një pretendim i pavërtetë, pasi aktet e fashikullit të hetimit administrativ provojnë të kundërtën

18.6. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit se: *për çështjet e bëra pjesë e hetimit administrativ, unë kam paraqitur prova dhe shpjegime (përfshirë dhe parashtrimin tim verbal në seancë dëgjimore), dhe se për shumicën e tyre trupi gjykues është shprehur se nuk kam dhënë shpjegime bindëse, pa evidentuar në asnjë rast se cili fakt apo argument nuk i është dukur bindës dhe cila është arsyeja përse kjo ndodh. Rrëzimi me një fjali shabllon se ata nuk janë bindur nga shpjegimet e mia të detajuara, tregon se ky trup gjykues vetëm i ka administruar formalisht provat dhe shpjegimet e paraqitura prej meje, por nuk i ka analizuar fare ato,* trupi gjykues konstaton se, nga përmbajtja e vendimit objekt shqyrtimi, rezulton se Komisioni ka referuar shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, duke dhënë edhe vlerësimin lidhur me to për çdo çështje të trajtuar, si për sa i përket kontrollit të pasurisë, ashtu edhe vlerësimit të aftësive profesionale⁶. Në këto kushte, vetë përmbajtja e vendimit të Komisionit demonstroi se ky pretendim i subjektit është i pabazuar. Fakti që Komisioni provat dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti nuk i ka konsideruar të mjaftueshme për të ndryshuar rezultatet e hetimit administrativ, nuk do të thotë që nuk i ka vlerësuar ato, por që ka pasur një vlerësim të ndryshëm nga ai i pritshëm nga subjekti i rivlerësimit, e cila mbetet një çështje diskrecionale e organeve të rivlerësimit, në zbatim të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016. Në të tilla kushte, edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar dhe i pambështetur në prova dhe në ligj.

18.7 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *vendimi i Komisionit që ka dhënë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, është i paarsyetuar, duke shkelur në këtë mënyrë një element të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor e duke mos plotësuar standardet e arsytimit të vendimit të përcaktuar si të tilla nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese,* trupi gjykues konstaton se mbështetet në argumentin se mungesa e arsytimit të mjaftueshëm e në standarde të pranueshme të vendimit përfundimtar, e bën procesin administrativ të zhvilluar ndaj tij si *nul*. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni në arsytimin e vendimit nuk ka respektuar qëndrimet e vendimit nr. 2, datë 26.01.2015 dhe nr. 55, datë 18.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese, që përcaktojnë elementet e arsytimit të vendimit, duke pretenduar se mungesa e këtij arsytimi passjell që ai të jetë me të meta dhe i cenueshëm. Edhe në këtë rast, trupi gjykues vëren se subjekti nuk evidenton asnjë situatë apo çështje konkrete që sipas tij ka mbetur e paarsyetuar në vendimin e Komisioni. Nga sa ka parashtruar në të gjithë ankimin e tij, subjekti pretendon se *Komisioni duhet të pranojë se subjekti ka pohuar vetë situatën faktike, duke u shprehur vetë jo në pak raste se “këtë çështje ka harruar ta deklarojë”, “është e vërtetë që është deklaruar gabim”*. Pavarësisht paqartësisë së këtij

⁵ Shih paragrafin 15; e nënparagrafët 15.1 e 15.2 të vendimit objekt gjykimi.

⁶ Shih paragrafët e vendimit të Komisionit 26.1.4; 26.2.2; 26.6.2; 27.4; 41.2.3; 41.3.4 etj.

pretendimi, trupi gjykues kontrolloi arsyetimin e vendimit në tërësinë e tij dhe nuk konstatoi në të elemente, të cilat mund të cenonin arsyetimin e vendimit si një element të procesit të rregullt. Për më tepër, në vendimin e arsyetuar të Komisionit nuk gjenden konkluzione që janë ngritur në nivelin e një shkaku shkarkimi, të cilat të mos jenë analizuar dhe arsyetuar. Përkundrazi, rezulton se Komisioni për çdo çështje të marrë në analizë, si në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, ashtu edhe të aftësive profesionale, ka evidentuar në vendim qëndrimin/shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, si dhe ka dhënë qëndrimin e tij lidhur me to. Në të tilla kushte, trupi gjykues çmon se ky pretendim i subjektit mbetet thjesht deklarativ dhe i pambështetur në prova e ligj.

18.8. Lidhur me pretendimin e subjektit se *Komisioni, në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk ka konsideruar se ligjvënësi ka vendosur që gjatë rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të sanksionojë standardin e moslejimit të justifikimit më shumë se të dyfishit të pasurisë së të ardhurave të ligjshme të dokumentuara*, trupi gjykues konstaton se, referuar konkluzioneve të Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti është konsideruar me mungesë të burimeve të ligjshme për të financuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera. Në këto kushte, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë se pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të krijuara prej tij, përfshirë ato likuiditet, i ka krijuar me burime financiare të ligjshme. Në këtë kuptim, trupi gjykues çmon se për sa kohë subjekti gjendet në kushtet kur të ardhurat e përdorura për krijimin e pasurive nuk provohet se janë krijuar nga burime të ligjshme, nuk mund të diskutohet për zbatimin e nenit D, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, e cila ka gjetur reflektim në nenin 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, trupi gjykues, ashtu siç ka analizuar edhe në raste të tjera të ngjashme, çmon se qenia e subjektit në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme sipas nenit 33, pika 5/b e ligjit nr. 84/2016, e pamundëson aplikimin e nenit 6, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, e cila mund të gjejë aplikim në rastet kur subjektet e rivlerësimit pasurinë e kanë krijuar edhe me të ardhura me burime të ligjshme, por për të cilat nuk provohet se janë paguar detyrimet tatimore dhe, si të tilla, nuk plotësojnë kushtet e nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, për t'u konsideruar si të ardhura të ligjshme. Për pasojë, trupi gjykues edhe këtë shkak ankimi e gjen të paargumentuar dhe të pabazuar ligjërisht.

II. Analiza e shkaqeve që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

- 19.** Lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 89 m², në Lezhë, të siguruar me kontratën nr. {***}, datë. 25.7.2012, me vlerë 3.355.171 lekë, subjekti i rivlerësimit pretendon se *konkluzionet e vendimit të Komisionit nuk janë të drejta dhe të bazuara, për sa vijon: Subjekti i rivlerësimit ka qenë kontradiktor lidhur me kohën e fillimit të jetesës në këtë apartament dhe se nuk ka pasur burime të ligjshme për mobilimin e këtij apartamenti, në shumën (-) 409.442 lekë, në muajin mars të vitit 2006, që konsiderohet momenti kur ka filluar të banojë në këtë apartament.* Në funksion të shqyrtimit të shkaqeve të mësipërme, trupi gjykues, në analizë të akteve të administruara në fashikullin e hetimit administrativ, konstatoi dhe analizoi si vijon.

19.1. Në vendimin e Komisionit, për këtë shkak ankimi është konkluduar se:

Në përfundim, rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve të mobilimit të apartamentit, në shumën 409.442 lekë, e cila, në vlerësim të Komisionit, duke u bazuar edhe në parimin e proporcionalitetit, nuk përbën shkak

autonom për shkarkimin e subjektit, por do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.

*Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 4.5.2021, ka deklaruar se ka filluar të banojë në këtë apartament në mars të vitit 2006. Deklarimi i tij se periudha mars – korrik 2006 ka shërbyer për riparimin e apartamentit, nuk përputhet me deklaratën noteriale të shoqërisë “{***}” ShPK, të dorëzuar nga vetë subjekti, në të cilën kjo shoqëri deklaroi se punimet janë bërë në periudhën shkurt - mars dhe janë dorëzuar te banorët. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka paraqitur së bashku me deklaratën “vetting” një dokument që nuk përmban të dhëna të sakta, pasi bazuar në deklaratimet e tij, ai ka jetuar në këtë apartament që nga marsi i vitit 2006 dhe jo nga korriku i vitit 2006. Ky fakt do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.*

19.2. Nga aktet e fashikullit, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka fituar pronësinë mbi një apartament të ndodhur në qytetin e Lezhës, për shkak të pasjes së statusit “i pastrehë” nga Enti Kombëtar i Banesave (në vijim “EKB”) me sip. 89 m², me kontratë nr. {***}, datë 25.7.2012, me vlerë 3.355.171 lekë. Komisioni ka shtrirë hetimin administrativ ndër të tjera mbi mundësinë e subjektit për të përballuar me burime të ligjshme mobilimin e tij, duke qenë se ka konkluduar se fitimi i pronësisë së apartamentit rezulton pa problematika që mund të ndikojnë procesin e rivlerësimit për subjektin. Në funksion të këtij hetimi, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, datë 11.03.2021, i ka kërkuar subjektit të deklarojë lidhur me mobilimin e këtij apartamenti duke përcaktuar për çdo vit shpenzimet përkatëse. Në përgjigje të kësaj pyetjeje, subjekti me shpjegimet e dhëna më datë 19.03.2021, ka sqaruar se në momentin e hyrjes në këtë banesë, ka shpenzuar 500.000 lekë për mobilimin e tij [...], ndër vite kemi bërë rreth 100.000 lekë shpenzime.

19.3. Në vijim, meqenëse shpjegimi i dhënë nga subjekti në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, sqaron plotësisht kostot e mobilimit për efekt të analizës financiare, Komisionit i është nevojitur edhe përcaktimi i kohës kur subjekti ka filluar të banojë në këtë banesë dhe, për këtë arsye, me pyetësorin nr. 3, të datës 04.05.2021, rezulton se i ka përcjellë subjektit pyetjet si vijojnë:

*Bazuar në deklaratën noteriale nr. {***}, datë 22.12.2010, ju keni deklaruar se keni hyrë në apartamentin në qytetin e Lezhës në fund të vitit 2005 dhe e keni merretuar atë, sepse në fillim nuk ka qenë në kondicione teknike. Në pyetësorin nr. 2, ju keni deklaruar se kur keni hyrë në këtë banesë, keni shpenzuar shumën 500.000 lekë. Lutemi të na informoni lidhur me: (a) Kur i keni kryer merremetimet e këtij apartamenti dhe sa ka qenë shuma e shpenzuar nga ana juaj, shoqëruar me dokumentacion provues. Nëse i keni kryer në vitin 2005 dhe 2006, lutemi të specifikoni vlerat për secilin vit. (b) Kur e keni kryer mobilimin e këtij apartamenti? Nëse e keni kryer në vitin 2005 dhe 2006, lutemi të specifikoni vlerat për secilin vit. Në përgjigje të kësaj pyetjeje, subjekti ka sqaruar se për këtë banesë të përfituar nga EKB-ja në fillim të muajit janar të vitit 2006, ka komunikuar me firmën ndërtuese për riparimin e disa defekteve të dritareve dhe dyert e brendshme, si dhe rënie të pjesshme të suvatimit, e cila i ka riparuar me punëtorët e saj dhe pa pagesë. Ai shpjegon gjithashtu se në muajin mars të vitit 2006, ka filluar të banojë në këtë banesë, duke e mobiluar me shumën e lartpërmendur. Mbështetur mbi këto fakte të servitura prej vetë subjektit, Komisioni ka kryer analizën financiare për periudhën në fjalë dhe me rezultatet paraprake të hetimit, i ka bërë me dije subjektit se ai rezulton të ketë mungesë të burimeve të ligjshme, në vlerën prej (-) 409.442 lekësh, për të justifikuar mobilimin e*

apartamentit, dhe i ka kaluar barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

19.4. Në përgjigje të rezultateve paraprake të hetimit, subjekti ka shpjeguar se: *Në lidhje me mobilimin e apartamentit të dhënë nga EKB-ja, të datës 12.02.2016⁷, kam deklaruar 300.000 lekë, e cila është e saktë. Ndërsa në pyetësonin nr. 2, të datës 11.03.2021, unë i jam përgjigjur pyetjes 1/e ku thuhet: “Lutemi të na informoni mbi vlerën e mobilimit të tij, duke cituar për çdo vit shpenzimet përkatëse”, prandaj është deklaruar shuma 500.000 lekë, duke nënkuptuar shpenzimet të shtrira ndër vite deri në vitin 2020, edhe ky është deklarim i saktë. Ju lutem që në analizën e tremujorit të parë të vitit 2006, të merret në konsideratë shuma 300.000 lekë dhe jo 500.000 lekë, pasi diferenca 200.000 lekë është e shtrirë ndër vitet pasardhëse. Diferenca që krijohet për tremujorin e parë të vitit 2006, gjetur nga ana e juaj, mendoj se duhet të rishikohet dhe të bëhet analiza për 6 muajt e parë të vitit 2006, pasi kjo është periudha për të cilën ne kemi bërë përgatitjet për të hyrë në banesë. Sipas një përllogaritjeje times, rezulton se për këtë periudhë, janë këto të dhëna. Lidhur me kohën e mobilimit të apartamentit në Lezhë, subjekti ka shpjeguar se: Unë kam jetuar në godinën e Prokurorisë nga nëntori i vitit 1998 - korrik të vitit 2006. Deklarimi im se nga marsi i vitit 2006, kam jetuar në apartamentin e përfutur nga ana e EKB-së, është bërë pasi kam pasur në konsideratë momentin kur unë kam marrë në administrim apartamentin. Periudha mars – korrik 2006 ka shërbyer për riparimin e përshtuar më lart dhe përgatitjen e apartamentit për të sjellë familjen. Të njëjtat shpjegime si më lart përmendur, subjekti i ka parashtruar edhe në ankim, por pa i shoqëruar me ndonjë dokumentacion mbështetës.*

19.5. Për sa më sipër, trupi gjykues, në analizë të të dhënave lidhur me kostot e mobilimit, vëren se Komisioni, duke konsideruar mungesën e deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike vjetore (në vijim “DPV”) të viteve 2004 dhe 2005 të shpenzimeve të kryera për mobilim, si edhe në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti në përgjigjet e pyetësonit nr. 2 lidhur me to dhe kohën e kryerjes së tyre, i ka pozicionuar ato si shpenzim në vlerën prej 500.000 lekësh, në analizën financiare të tremujorit të parë të vitit 2006. Subjekti, pasi është njohur me këtë analizë financiare të kryer nga Komisioni në shpjegimet për rezultatet e hetimit, ka ndryshuar shpjegimet e tij duke u shprehur se vlera 500.000 lekë përfaqëson të gjitha shpenzimet për mobilim deri në vitin 2020 dhe se në apartamentin në Lezhë të përfutur nga EKB-ja, periudha mars-korrik 2006 ka shërbyer për riparimin e apartamentit nga shoqëria ndërtuese. Trupi gjykues vëren se në ankim, subjekti jep të njëjtat shpjegime si ato të dhëna prej tij në rezultatet e hetimit administrativ për kostot e mobilimit të apartamentit të përfutur nga EKB-ja, ndërsa për sa i përket kohës kur ka filluar të jetojë në këtë banesë, në ndryshim nga shpjegimet e dhëna për rezultatet e hetimit, specifikon se ka filluar të jetojë në qershor të vitit 2006. Për të provuar pretendimin se ka filluar të banojë në këtë apartament në qershor të vitit 2006, subjekti ka përdorur vërtetimin e lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë nr. {***} prot., datë 24.01.2020, sipas të cilit subjekti ka jetuar në katin e tretë të godinës së Prokurorisë për periudhën nëntor 1998 - korrik 2006.

19.6. Në analizë të deklarimeve e shpjegimeve të subjektit të dhëna gjatë hetimit administrativ lidhur me kostot e mobilimit dhe shpërndarjen e tyre në kohë, trupi gjykues vëren se shpjegimet vijuese të subjektit të dhëna për rezultatet paraprake të hetimit si dhe ato të dhëna në ankim,

⁷ I referohet një procesverbalit të mbajtur në ILDKPKI me subjektin.

dukshëm synojnë copëzimin/shpërndarjen e tyre në vite, në funksion të reduktimit të tyre si shpenzim i vitit 2006, me qëllim përmirësimin e situatës financiare të këtij viti. Për këtë arsye, trupi gjykues i vlerëson të pabesueshme këto deklaratime, të cilat jo vetëm janë modifikuar në kohë, në përputhje me nevojat e subjektit për uljen e rezultatit negativ financiar të rezultateve të hetimit, duke treguar mungesë koherence e sinqeriteti, por ato edhe janë modifikuar në vlera shumë të ulëta dhe të papërfillshme për të siguruar mobilimin e një banese. Shpërndarja e tyre deri në vitin 2020, i shndërron shpjegimet e subjektit në krejtësisht jorelevante, për shkak të deformimit ndjeshëm të realitetit. Në drejtim të saktësisimit të analizës financiare, trupi gjykues konstatoi gjithashtu subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar përdorimin apo pakësimin e këtyre kursimeve në DPV-në e vitit 2006, fakt i cili provon se këto likuiditete nuk janë përdorur për financimin e mobilimit në këtë vit, për pasojë nuk gjenden elemente për të ndryshuar analizën ekonomike të bërë nga Komisioni lidhur me mobilimin. Gjithashtu, fakti që subjekti ka deklaruar në DPV-në e vitit 2005, të plotësuar në mars 2006, si adresë banimi njësinë administrative “{***}”, pallati {***}, Lezhë, e cila përkon me adresën e apartamentit 89 m² të përfituar nga EKB-ja, është një element tjetër që të çon drejt arsyetimit se në mars të vitit 2006, kishte përfunduar mobilimin e këtij apartamenti.

19.7. Lidhur me kohën e fillimit të banimit në këtë apartament, trupi gjykues konstaton se edhe në këtë rast, shpjegimi i dhënë nga subjekti në ankim se ka filluar të banojë atje në qershor të vitit 2006, në ndryshim nga përgjigjet e dhëna fillimisht në përgjigje të pyetësorëve se ka filluar të banojë në mars të këtij viti, mbetet thjesht në nivel deklarativ. Në të kundërt, deklarimi fillestar për fillimin e banimit në periudhën mars 2006, duket se mbështetet edhe nga deklarimi i vendbanimit që subjekti ka bërë në DPV-në e vitit 2005, plotësuar në mars të vitit 2006, në të cilën ka vendosur si adresë banimi njësinë administrative “{***}”, pallati {***}, Lezhë, e cila përkon me adresën e apartamentit të përfituar nga EKB-ja. Vërtetimi i lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë⁸, për të provuar periudhën e qëndrimit në godinën e këtij institucioni, nuk referon në ndonjë të dhënë dokumentare apo gjurmë shkresore, madje nuk paraqet as burimin e informacionit, duke konsideruar faktin që personi i cili e ka nënshkruar atë nuk është i njëjtë me drejtuesin e kohës që subjekti pretendon se ka qëndruar në këtë godinë, në këtë kuptim ajo nuk paraqet vlera provuese, por duket se replikon qëndrimin e subjektit për periudhën e qëndrimit.

19.8. Në përfundim, lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues, pasi analizoi pretendimet e subjektit të ngritura në ankim, në raport me të dhënat e rezultuara gjatë hetimit dhe pohimet që vetë subjekti ka bërë gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, lidhur me përcaktimin e vlerës së këtyre shpenzimeve dhe kohës së kryerjes së tyre, arriti në përfundimin se me të drejtë, Komisioni ka ngarkuar subjektin me shpenzim në vlerën prej 500.000 lekësh, si kosto e mobilimit të apartamentit, në periudhën e tremujorit të parë të vitit 2006. Vlerësimi i Komisionit me të drejtë u është referuar deklaratimeve që vetë subjekti i rivlerësimit kishte bërë rishtas në përgjigje të pyetësorit të parë dhe të konfirmuar edhe më pas, duke e bërë të pabesueshëm ndryshimin e këtyre deklaratimeve në një fazë të avancuar të hetimit, në funksion të përmirësimit të situatës financiare të tij. Për pasojë, nga kontrolli i ushtruar në Kolegj, konfirmohet si e saktë analiza financiare e kryer në Komision dhe konkludohet se subjekti gjendet në kushtet e

⁸ Në mbështetje të këtij qëndrimi, subjekti ka depozituar vërtetimin nr. {***} prot., datë 21.01.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në të cilin shprehet se subjekti ka jetuar në katin e tretë të kësaj godine për periudhën 1998 - korrik 2006.

mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar kryerjen e këtyre shpenzime, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

20. Trupi gjykues mori në shqyrtim shkakun e ankimit që i referohet pasurisë apartament me sip. 53 m², në qytetin e Shëngjinit, ndërtuar në vitin 2006, të blerë nga shoqëria “{***}” ShPK, me vlerë 21.500 euro, nëpërmjet të cilit subjekti i rivlerësimit *konsideron si jo të drejta e të sakta, në përputhje me shpjegimet e tij, konkluzionet e Komisionit se: (i) këtë pasuri nuk e ka deklaruar në mënyrë të plotë dhe të saktë në deklaratën “vetting”, për sa i përket vitit të krijimit dhe burimeve të financimit të saj dhe se nuk ka justifikuar me burime të ligjshme financimin e blerjes së kësaj pasurie; (ii) në kushtet kur subjekti në vitin 2002 ka hetuar çështjen penale me të pandehur z. L. Rr., ndërkohë që: (a) kishte porositur një apartament te shoqëria në të cilën z. Rr. ishte ortak i vetëm; (b) kishte marrëdhënie shoqërore me këtë shtetas; si dhe (c) sipas pretendimeve të tij, i kishte dhënë hua një shumë të konsiderueshme z. Rr. – ai ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, bazuar në nenet 17/1 dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale.*

20.1 Në vendimin e Komisionit, lidhur me këtë pasuri, është analizuar dhe konkluduar se: Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme, në shumën 2.328.815,32 lekë, për ndërtimin e këtij apartamenti, si dhe nuk ka pasqyruar në mënyrë të plotë dhe të saktë në deklaratën “vetting”, burimet dhe kohën e saktë të kryerjes së pagesave. Pas analizës së fakteve dhe provave, Komisioni vlerëson se subjekti: (i) nuk ka justifikuar me burime të ligjshme krijimin e pasurisë apartament, të ndodhur në Shëngjin; (ii) nuk ka deklaruar në deklaratën “vetting”, në mënyrë të plotë dhe të saktë pasurinë; si dhe (iii) gjendet në situatën e konfliktit të interesit. Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germave “a” dhe “b” të nenit 33/5 dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, si dhe gjendet në situatën e konfliktit të interesit, në kuptim të germës “d” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

20.2 Në drejtim të verifikimit të deklarimeve të subjektit lidhur me këtë pasuri, në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe në deklarimet periodike vjetore lidhur me këtë pasuri, ka rezultuar përkatësisht: (i) në deklaratën e pasurisë *vetting*, është deklaruar: *Apartament banimi, me sip. 53 m², në qytetin e Shëngjinit, ndërtuar në vitin 2006, marrë nga shoqëria “{***}” ShPK, me vlerë 21.500 euro, me marrëveshje është rënë dakord për vlerën 2.200.000 lekë, nga të cilat 1.600.000⁹ lekë janë likuiduar dhe diferenca do të likuidohet pas hipotekimit të apartamentit. E paregjistruar në regjistrat hipotekorë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat nga puna deri në vitin 2002 dhe dhënë gjatë kësaj periudhe ndër vite; (ii) në DPV-në e vitit 2009, në të cilën është deklaruar për herë të parë kjo pasuri, është deklaruar: *Banesë 2+1 (65 m²), Shëngjin, blerë te firma “{***}” ShPK, nga kursimet e mia dhe të bashkëshortes, në vlerën 21.000 euro.**

20.3 Nga kontrata e sipërmarrjes nr. {***}, datë 08.08.2006, e nënshkruar nga bashkëshortja e subjektit, rezulton se ajo ka porositur nga shoqëria “{***}” ShPK, ndërtimin e një apartamenti banimi me sip. 53 m², me çmim 400 euro/m², në vlerën 21.500 euro. Në nenin 4 të saj, të titulluar

⁹ Për të provuar deklaramin e tij, subjekti ka depozituar deklaratën e datës 24.11.2011 (e **panoterizuar**), nga shtetasi L. Rr., i cili ka deklaruar se në bazë të kontratës nr. {***}, datë 8.8.2006, ka shitur apartament banimi me sip. 65 m², në shumën 21.500 euro (në vlerën 2.200.000 lekë), nga e cila i janë dhënë vetëm shuma 1.600.000 lekë dhe pjesa tjetër prej 600.000 lekësh nuk është paguar, pasi nuk është kryer hipotekimi i pallatit.

“Mënyra e pagesës”¹⁰, përcaktohet se *porositësja e likuidon shoqërinë jashtë zyrës së noterisë*. Përveç sa më sipër, në kërkesën e datës 04.04.2017, me nr. {***} prot., me anë të së cilës bashkëshortja e subjektit ka kërkuar legalizimin e këtij objekti pranë ALUIZNI-t¹¹, është specifikuar se ai është ndërtuar në vitin 2002.

20.4 Nga analizimi i deklarimeve periodike të pasurisë, DPV-të e viteve 2006, 2007 dhe 2008 të subjektit dhe të personave të lidhur, si dhe i kontratës së sipërmarrjes së sipërcituar me nr. {***}, datë 08.08.2006, konstatohet se pavarësisht se apartamenti në Shëngjin është porositur në vitin 2006, nga ana e subjektit kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në DPV-në e vitit 2009. Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar *të ardhurat nga puna deri në vitin 2002*, në DPV-në e vitit 2009 subjekti ka deklaruar si burim krijimi kursimet e tij dhe të bashkëshortes, pa përcaktuar periudhën që i përkasin ato. Gjithashtu konstatohet se në deklaratimet periodike nga viti 2003 e deri në vitin 2009, prej subjektit nuk janë deklaruar kursime në *cash*, të cilat të jenë përdorur për shlyerjen e detyrimeve kontraktuale për blerjen e apartamentit në Shëngjin, si dhe nuk është deklaruar ndonjë pagesë e kryer për të shlyer detyrime lidhur me këtë pasuri.

20.5 Lidhur me këtë situatë, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime edhe pranë ILDKPKI-së, përkatësisht në vitet 2010, 2011 dhe 2016, duke deklaruar sa vijon.

(i) Sipas procesverbalit të datës 12.10.2010, subjekti është pyetur në lidhje me të ardhurat neto të deklaruara, të cilat nuk mbulojnë asetet e krijuara prej tij në DPV-në 2009, apartament në vlerën 21.000 euro, si dhe gjendjen e kursimeve prej 800.000 lekësh pranë Raiffeisen Bank. Në përgjigje të kësaj pyetjeje, subjekti ka shpjeguar se: *Kontratën me shoqërinë “{***}” ShPK e ka lidhur para vitit 2009 bashkëshortja, pavarësisht se kontrata është në euro, bashkëshortja i ka dhënë pronares së asaj shoqërie shumën 1.600.000 lekë dhe i detyrohet edhe 600.000 lekë. Ndërsa në lidhje me burimin e krijimit, subjekti ka shpjeguar se: Unë kam 30 vjet punë në organet e drejtësisë. Në vitin 1997 jam martuar, dhe të gjitha të ardhurat që kemi marrë deri në momentin e marrjes së të ardhurave nëpërmjet bankës, kam deklaruar vetëm të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes vjetore dhe nuk kam deklaruar kursimet e çdo viti, me idenë se këto kursime rezultojnë nga shumëzimi i shumave të dhëna në deklaratime dhe shpenzimeve të përcaktuara nga ligji. [...] shumën që pretendohet se nuk e mbuloj me të ardhurat e deklaruara në vitin 2009, e sqarova dhe më lart, pasi ato janë të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes sime dhe vijmë si rezultat i pagave dhe unë jam mjaftuar në deklaratim vetëm me deklaratimin e të ardhurave. Detyrimin ndaj shoqërisë nuk e kam deklaruar sepse nuk e dija. Këtë detyrim e mora në telefon nga bashkëshortja në momentin që ju po përpiloni procesverbalin.*

(ii) Në procesverbalin e mbajtur më datë 23.11.2011, në lidhje me shtimin e aseteve të deklaruara në vitin 2009, subjekti ka shpjeguar se: *Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, datë 12.10.2010, kam deklaruar se kam 30 vjet punë dhe kam deklaruar vetëm të ardhurat e përfituara dhe jo kursimet për çdo vit. Pra, shtesa e pasurisë në vitin 2009 ka lidhje me kursimet ndër vite nga puna ime dhe bashkëshortja, të cilat i kam deklaruar si të ardhura dhe e përsëris se nuk kam deklaruar pjesën e kursimeve gjendje në çdo vit. Gjithashtu, si burim është dhe shuma prej 600.000 lekësh, e papaguar firmës “{***}” ShPK.*

¹⁰ Neni 4 i kontratës së sipërmarrjes nr. {***}, të datës 08.08.2006, përcakton se: “Porositësja likuidon shoqërinë “{***}” ShPK jashtë zyrës noteriale”.

¹¹ Kërkesë e cila është miratuar dhe pasuria me nr. {***}, ZK {***} figuron tashmë e regjistruar në ASHK Lezhë.

(iii) Ndërsa në procesverbalin e datës 12.02.2016, pasi është pyetur sërish në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar: *Në këtë banesë, me anë të një kontrate porosisë me firmën “{***}” ShPK, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., më datë 08.08.2006, me drejtues ligjor z. L. Rr., e kam porositur për një shumë prej 21.000 eurosh (2.200.000 lekë). Kontrata është lidhur nga bashkëshortja ime F.. Sipas edhe deklaratës së shtetasit L. Rr. më datë 24.11.2011, të cilën po e dorëzoj dhe e kam paraqitur edhe më parë në Inspektorat, deklarohet se u bë më datë 08.08.2006 dhe i kam dhënë shumën 1.600.000 lekë, dua të shtoj se këtë shumë prej 1.600.000 lekësh, të cilat janë kursimet e mia personale dhe të bashkëshortes pas martesë, ia kisha dhënë para shumë viteve, pasi me shtetasin L. Rr. kemi miqësi prej vitesh. Meqenëse për shkak të aktivitetit të tij tregtar me anije peshkimi që prej vitit 1996, unë kam nisur dhe i kam dhënë shuma që ishin nga 100.000 lekë deri në 200.000 lekë. Në momentin që shtetasi L. Rr. po bënte një ndërtim banesë dhe ankohej për mosecjen e bizneseve të tij, unë kam lidhur kontratën e sipërmarrjes të cilën e citova më lart dhe aktualisht i jam borxh këtij shtetasi në shumën 600.000 lekë, kjo për shkak të mosdhënies së certifikatës së pronësisë nga ana e tij.*

20.6 Lidhur me këtë situatë, Komisioni i ka drejtuar pyetje subjektit përgjatë hetimit administrativ, në pyetësorin e datës 21.01.2021, në përgjigje të të cilit subjekti ka shpjeguar se: **a)** *Arsyeja e mosdeklarimit ka qenë se pallati në të cilin kam përfutuar pronën, ka filluar ndërtimin në vitin 2002 nga firma “{***}” ShPK dhe në pamundësi për ta përfunduar brenda afateve, firma ndërpreu punimet për arsye financiare. Objekti ishte në hapat e parë të ndërtimit dhe në vitin 2006 kur u hodhën kolonat e pallatit për lartësitë, lidhëm kontratën e porosisë. Pra, si rezultat, unë nuk kisha pronë timen për të deklaruar. **b)** *Pallati përfundoi punimet në vitin 2009 (nga një firmë tjetër) dhe unë mora çelësat e banesës, pas kësaj u realizua kontrata e porosisë dhe unë u bëra me pronë pa dokumente. **c)** *Për deklaratën e dorëzuar në vitin 2010 për vitin 2009, jam thirrur për sqarim në ILDKPKI (në datën 12.10.2010), ku kam deklaruar me dokument të lëshuar nga pronari L. Rr. se për shumën sipas kontratës së porosisë të shumës 21.000 euro (2.200.000 lekë), bashkëshortja i ka dhënë shumën 1.600.000 lekë dhe i detyrohet shumën 600.000 lekë. Unë nuk e kam deklaruar në DPV-të e viteve pasardhëse, pasi e kam quajtur të deklaruar dhe do ta deklaroja vetëm si shlyerje borxhi të cilin unë do t’ia jepja pasi të merrej certifikata e pronësisë. **d)** *Deri në vitin 2003, unë dhe bashkëshortja i kemi marrë pagat cash dhe jo me bankë, para këto të mbajtura në banesë. Nga kursimet e mia dhe të bashkëshortes në këto vite është ruajtur kjo shumë parash dhe i është dhënë në mënyrë të pjesshme, sa herë i është dashur për të kryer veprime të ndryshme financiare, çiftit Rr., në formë huaje, pasi kishin lidhje shoqërore me ta. Kjo shumë iu është dhënë pa veprime para noterit apo deklaratë dore, por në mirëbesim. Pra, arsyeja e mosdeklarimit është se në vitet kur filloi deklarimi nuk e kisha “cash” në banesë këtë shumë, por ia kisha dhënë hua dhe nuk kisha asnjë dokument për këtë borxh të dhënë.****

20.7 Në analizë të deklaratimeve e shpjegimeve të subjektit lidhur me mënyrën e fitimit të pronësisë mbi këtë pasuri, burimet e krijimit të saj dhe kohën e pagimit të çmimit, konstatohet lehtësisht se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime kontradiktore çdo herë që është pyetur si nga ILDKPKI-ja në vitet 2010, 2011 e 2016, ashtu edhe gjatë hetimit të Komisionit. Për shkak të këtyre deklaratimeve, rezulton e vështirë të merret një qëndrim rreth fakteve të ndodhura dhe kohës së tyre, duke vështirësuar punën e organeve të rivlerësimit për të bërë një vlerësim që i afrohet sa më shumë së vërtetës jetësore lidhur me faktet juridike që kanë shoqëruar krijimin e kësaj pasurie. Pavarësisht kësaj paqartësie e kontradiktoriteti, trupi gjyqësor, në analizë të të

dhënave që vijnë nga shpjegimet e subjektit si më lart përshkruar, konstaton se deklaratimet e tij, të dhëna në deklaratën e pasurisë *vetting*, lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie dhe kohën e mënyrën e pagimit të çmimit të saj, nuk gjejnë mbështetje në deklaratimet e subjektit në DPV-në e vitit 2009, kur ai ka deklaruar rishtas këtë pasuri. Deklarimi i subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting*, se ai ka paguar vetëm 1.600.000 lekë dhe ka mbetur një detyrim i papaguar në vlerën prej 600.000 lekësh, jo vetëm që nuk është deklaruar si i tillë në DPV-në e vitit 2009, në të cilën e gjithë vlera është deklaruar si e shlyer, por as nuk është deklaruar si një detyrim i mbartur ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, në DPV-të vijuese. Pretendimi i subjektit se në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, ai ka sqaruar këtë situatë dhe për pasojë nuk e ka parë më të nevojshme të vijojë me deklarime lidhur me këtë detyrim, nuk e shkarkon atë nga detyrimi për deklarimin në deklaratat periodike, të detyrimeve financiare korrente, siç pretendohet se është shuma prej 600.000 lekësh. Për më tepër që konstatohet se thirrja dhe pyetja në ILDKPKI është bërë për shkak se subjekti nuk justifikonte me të ardhura të ligjshme të gjitha investimet e shpenzimet e vitit 2009, për pasojë shpjegimet e tij se në këtë vit është paguar vetëm një pjesë e çmimit, konsiderohen se janë në funksion të lehtësimit të situatës së tij financiare, por jo si deklarime të vullnetshme e të singerta. Në këto kushte, rezulton se deklarimi i bërë në deklaratën e pasurisë *vetting*, për pagimin pjesor dhe pasjes së një detyrimi të pashlyer për çmimin e kësaj pasurie, nuk verifikohet si i saktë nga deklaratat periodike të subjektit, të cilat konsiderohen si provë në këtë proces, sipas parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

20.8 Një pretendim i tillë nuk rezulton të gjejë pasqyrim as në kontratën e sipërmarrjes nr. {***}, të datës 08.08.2006¹², nëpërmjet së cilës është porositur ndërtimi i këtij apartamenti prej bashkëshortes së subjektit dhe as në ndonjë dokument financiar të kohës, mandatpagesë, transfertë bankare apo çfarëdolloj prove shkresore që do të provonte këtë pretendim apo do të jepte qoftë edhe inidicie në mbështetje të tij.

20.9 Përveç kohës së pagimit të çmimit për blerjen/porositjen e kësaj pasurie, objekt kontrolli nga Komisioni kanë qenë edhe deklaratimet e subjektit lidhur me burimet e krijimit të saj. Sipas deklaratimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, të ardhurat janë krijuar nga puna deri në vitin 2002 dhe të dhëna gjatë kësaj periudhe ndër vite. Në DPV-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar se apartamenti ka si burim, *kursimet e mia dhe bashkëshortes*. Ndërsa është pyetur nga ILDKPKI-ja në vitet 2010 e 2011 rreth këtyre burimeve, ai ka potencuar se kursimet e tij dhe të bashkëshortes kanë qenë nga paga deri para vitit 2006, kur është lidhur kontrata e sipërmarrjes, të cilat pavarësisht se kanë ekzistuar në gjithë këto vite punë, nuk janë deklaruar si të tilla. Subjekti ka modifikuar këto deklarime në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, në vitin 2016¹³,

¹² Në nenin 4 të kontratës së sipërmarrjes, është specifikuar se: “Porositësja likuidon shoqërinë “{***}” ShPK jashtë zyrës së noterisë”, dhe nuk ka asnjë përcaktim tjetër mbi detyrime të mbetura për t’u shlyer.

¹³ Në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, më datë 12.02.2016, subjekti ka deklaruar:

“[...] Dua të theksoj se unë prej vitit 1998-2006, që jam futur në banesën time të re, kam jetuar në ndërtesën e Prokurorisë Lezhë, ku nuk kam paguar para për qiranë. Mosdeklarimi i këtyre shumave të dhëna shtetasit L. Rr. në Deklaratën e Interesave Privatë të vitit 2003, nuk e kam deklaruar pasi mendova të bëja këtë kontratë të cituar më lart, për të përfituar paratë e dhëna në vite nga ana ime. Nuk e kam deklaruar këtë kontratë porosie në deklaratën e interesave të vitit 2006 sepse nuk kisha hyrë të jetoja në banesë. Në vitin 2009, pasi ka përfunduar objekti, unë kam hyrë të jetoj, dhe e kam deklaruar në Deklaratën Private të vitit 2009. Aktualisht, unë nuk e kam marrë certifikatën e pronësisë, prandaj edhe kjo pasuri nuk figuron në ZVRPP. Për sa u përket shpenzimeve të mobilimit për këtë apartament, theksoj se kjo shtëpi frekuentohet vetëm në periudhën e plazhit dhe ka vetëm krevate dhe mobilim bazë, shpenzimet e këtij apartamenti kanë qenë afërsisht 80.000 lekë, që prej vitit 2006 e deri sot nuk kam bërë shpenzime të tjera në këtë apartament”.

duke pretenduar për herë të parë një skenar të ndryshëm lidhur me to, sipas të cilit, në të vërtetë këto para nuk ishin paguar në kohën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, pasi ato ishin shlyer nëpërmjet kompensimit të një detyrimi që ndërtuesi, z. L. Rr., i kishte familjes së subjektit prej vitesh, para të dhëna hua për të mundësuar vijimin e biznesit të tij të ndërtimit, i cili gjendej në vështirësi në atë kohë. Në vijim, gjatë pyetje-përgjigjeve në Komision, subjekti ka përcaktuar se koha e dhënies së huas z. Rr. ishte deri në vitin 2002, duke u përpjekur t'i japë besueshmëri deklaramit të tij në deklaratën e pasurisë *vetting*, se si burim për krijimin e pasurisë kanë shërbyer të ardhurat e krijuara deri në vitin 2002. Subjekti ka sugjeruar në këtë mënyrë kryerjen e analizës financiare për mundësinë e krijimit të këtyre të ardhurave deri në këtë periudhë.

20.10 Këto shpjegime të subjektit, të dhëna jashtë kontekstit e përmbajtjes së deklaratave periodike, vlerësohen nga trupi gjykues si të pabesueshme. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar ndonjë shumë të dhënë hua z. Rr. as në deklaratën fillestare të pasurisë në vitin 2003, në të cilën do të duhej të gjente pasqyrim kjo marrëdhënie nëse ekzistonte, siç pretendon subjekti në këto shpjegime, e as në deklaratën e pasurisë *vetting*. Kjo huadhënie nuk është deklaruar as në deklaratat vijuese të pasurisë deri në vitin 2006, kur ajo pretendohet si e shlyer nëpërmjet kompensimit me çmimin e apartamentit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9049/2003. Ky fakt nuk ka gjetur pasqyrim as në kontratën e sipërmarrjes së lidhur mes bashkëshortes dhe z. Rr. dhe as në deklaramin në DPV-në e vitit 2006 për burimin e krijimit të pasurisë apartament, në të cilën ai përcaktohet si i krijuar nga kursimet nga pagat si i tillë, dhe jo shumat e parave të dhëna hua. Në këto kushte, duke konsideruar të gjitha elementet e mësipërme, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit, për shkak të shpjegimeve kontradiktore e jokoherente, ka dështuar të provojë vërtetësinë e deklaramëve të tij në deklaratën e pasurisë *vetting*, rreth burimeve të financimit të pasurisë apartament, si të krijuara deri në vitin 2002.

20.11 Në përfundim, trupi gjykues, në analizë të të dhënave që vinin nga të gjitha aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, veçanërisht nga deklaratat periodike vjetore të cilësuaru posaçërisht me vlerë provuese, sipas parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, vlerësoi të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta dhe të paplota në deklaratën e pasurisë *vetting*, lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie dhe kohën e pagimit të detyrimit të përcaktuar si çmim në kontratën e porosisë së lidhur në vitin 2006, mes shoqërisë “{***}” ShPK dhe personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit. Kjo situatë e vendos subjektin në kushtet e mosrespektimit të detyrimeve ligjore, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

- 21** Në vijim dhe mbështetur në qëndrimet e mësipërme lidhur me deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e tij lidhur me konkluzionin e Komisionit se ai nuk ka pasur burime të ligjshme për të financuar blerjen/porositjen e këtij apartamenti.

21.1 Nga analizi i akteve të fashikullit të hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, ndonëse ka pretenduar se pagesat për këtë pasuri janë bërë më vonë, dhe jo sipas parashikimit të kontratës së porosisë, nuk ka paraqitur ndonjë dokument mbështetës (si transferta banke apo mandatpagesa), me anë të të cilave të provojë pagimin e vlerës së apartamentit në Shëngjin, sipas kalendarit të përcaktuar prej tij. Nisur nga kjo situatë faktike,

Komisioni ka kryer analizën financiare për blerjen e këtij apartamenti duke konsideruar pagesën totale në vitin 2006, sipas parashikimit të kontratës së porosisë të nënshkruar nga bashkëshortja e subjektit, si dhe duke konsideruar si burim vetëm të ardhurat e këtij viti, pasi subjekti nuk kishte deklaruar kursime në *cash* në deklaratat periodike deri në këtë vit, si dhe nuk rezultojnë të ketë pakësuar depozitat e likuiditeteve në banka.

21.2 Trupi gjykues, në funksion të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit për padrejtësinë vendimit të Komisionit lidhur me verifikimin e burimeve që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, pasi analizoi dokumentet ligjore dhe shpjegimet e dhëna prej tij lidhur me këtë çështje, evidentoi se: **(i)** në deklaratat periodike të bëra nga subjekti ndër vite për burimet e financimit të apartamentit në Shëngjin, rezultojnë se prej tij nuk është deklaruar asnjëherë se fondet që kanë shkuar për financimin e kësaj pasurie, janë me burim nga kursimet ndër vite prej pagave; **(ii)** në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003, subjekti ka deklaruar kursime si depozitë¹⁴ në Bankën e Kursimeve në shumën 600.000 lekë, dhe në asnjë nga deklaratat periodike vijuese nuk ka deklaruar kursime të tjera në *cash*, si dhe nuk ka deklaruar pakësim të këtyre kursimeve me qëllim financimin e apartamentit në Shëngjin; **(iii)** në deklaratën e pasurisë *vetting* për apartamentin në Shëngjin, subjekti ka deklaruar se, si burim i financimit, kanë shërbyer kursimet deri në vitin 2002 e shlyer në vijim dhe se depozita bankare e deklaruar nga subjekti në DVP-në 2003 para fillimit të detyrës, me vlerë fillestare prej 600.000 lekësh, nuk rezultojnë të jetë pakësuar në momentin e blerjes së apartamentit në Shëngjin; **(iv)** subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, mosdeklarimit e përfitimit të kësaj pasurie e lidh me mospasjen e pronësisë lidhur me të, dhe nuk e vlerëson këtë situatë në kuptim të detyrimeve që ka pasur si subjekt deklarues i pasurisë në zbatim të nenit 4, germa “dh” e ligjit nr. 9049/2003, për të deklaruar të gjitha detyrimet financiare që ai kishte ndaj personave fizikë e juridikë.

21.3 Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se pretendimi i ankimit të subjektit se, për efekt të analizës financiare duhet të konsiderohen si burime për financimin e kësaj pasurie të gjitha vlerat që nga analiza financiare rezultojnë si mundësi potenciale e kursimeve në *cash*, vit pas viti, është një pretendim që mbetet thjesht deklarativ, i pambështetur në prova e në ligj, për sa kohë vetë subjekti në DPV-të respektive nuk ka deklaruar kursime në *cash*, në përputhje e në zbatim të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji nr. 9049/2003. Gjithashtu, fakti që subjekti për depozitën bankare të deklaruar në DPV-në fillestare të vitit 2003, nuk ka deklaruar pakësim të fondeve në momentin e blerjes së apartamentit në Shëngjin, pamundëson edhe përdorimin e saj si burim për blerjen e këtij pasurie.

21.4 Për sa i përket pretendimit të subjektit se: *Fakti që apartamenti është porositur në vitin 2006, nuk do të thotë se janë bërë pagesa, pasi ndërmjet meje dhe ndërtuesit, z. L. Rr., ka ekzistuar një marrëdhënie reale detyrimi huaje, e cila ka qenë informale, trupi gjykues konstaton e analizon si vijon.*

21.5 Në DPV-në e vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Banesë 2+1 në Shëngjin, me vlerë 21.000 euro, blerë te firma “{***}” ShPK Lezhë, me burimin nga kursimet e mia dhe të bashkëshortes. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, më datë 10.12.2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kontrata me shoqërinë “{***}” ShPK është lidhur para vitit 2009*

¹⁴ Në DVP-në fillestare të vitit 2003, subjekti ka deklaruar: “Depozitë 600.000 lekë në Bankën e Kursimeve, me përshkrimin “kursime””.

(por nuk specifikon vitin e saktë kur është lidhur), nga bashkëshortja, pavarësisht se kontrata është lidhur në euro, bashkëshortja i ka paguar pronares së kësaj shoqërie, shumën 1.600.000 lekë dhe i detyrohem 600.000 lekë. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, më datë 12.02.2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *Kontrata e sipërmarrjes 08.08.2006, është lidhur nga bashkëshortja ime F.. Sipas edhe deklaratës së shtetasit L. Rr. më datë 24.11.2011, të cilën po e dorëzoj dhe e kam paraqitur edhe më parë në Inspektorat, deklarohet se u bë më datë 08.08.2006 dhe i kam dhënë shumën 1.600.000 lekë, dua të shtoj se këtë shumë prej 1.600.000 lekësh, të cilat janë kursimet e mia personale dhe të bashkëshortes pas martese, ia kisha dhënë para shumë viteve, pasi me shtetasin L. Rr. kemi miqësi prej vitesh. [...]* Mosdeklarimi i këtyre shumave të dhëna shtetasit L. Rr. në Deklaratën e Interesave Privatë të vitit 2003, nuk e kam deklaruar pasi mendova të bëja këtë kontratë të cituar më lart për të përfutur paratë e dhëna në vite nga ana ime. Nuk e kam deklaruar këtë kontratë porosie në deklaratën e interesave të vitit 2006 sepse nuk kisha hyrë të jetoja në banesë. Këtë version të shpjegimeve lidhur me pagesat e apartamentin në Shëngjin, subjekti duket se e ka mbajtur edhe në përgjigjet që ka dhënë gjatë hetimit administrativ në Komision më datë 21.01.2021. Në ankim, subjekti mosdeklarimin e huas me z. Rr. në DPV-në fillestare e ka justifikuar me faktin se ajo ishte e padokumentuar.

21.6. Në analizë të deklarimeve të përmendura më lart, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit është shfaqur kontradiktor në shpjegimet që ai ka dhënë për të justifikuar burimet e ligjshme të financimit të kësaj pasurie. Ai ka devijuar burimin e krijimit të saj të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* nga një burim i krijuar me kursimet nga pagat, në një burim që ka ardhur për shkak të kompensimit të një detyrimi që i porosituri, z. Rr., kishte pasur ndaj tij, të padeklaruar asnjëherë më parë në DPV-në. Përveç sa më sipër, në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar se vlera e dhënë për financimin e kësaj pasurie, është paguar ndër vite, duke nënkuptuar sipas këtij deklarimi se shuma është krijuar deri në vitin 2002, por ajo është shlyer ndaj të porositurit, me pjesë ndër vite. Këto deklarime në deklaratën *vetting* nuk mbështeten nga deklaratimet e subjektit në DPV-në e vitit 2009, në të cilën ai ka deklaruar se si burim për krijimin e kësaj pasurie, *janë kursimet e tij dhe bashkëshortes*, pa specifikuar se kur daton krijimi i tyre. Gjithashtu, në të gjitha deklaratat periodike, përfshirë atë fillestare, nuk gjen pasqyrim marrëdhënia e huas të pretenduar me z. Rr., e cila është pretenduar si fakt për herë të parë në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, në shkurt të vitit 2016, por nuk është pasqyruar si e tillë në deklaratën e pasurisë *vetting*. Për më tepër, nga hetimi administrativ, është evidentuar se financat dhe situata financiare e shoqërisë “{***}” ShPK, rezultojnë të jenë pozitive në vitet 1999 deri 2002¹⁵, në ndryshim nga sa ka deklaruar subjekti për të justifikuar nevojën e z. Rr. për hua, për shkak të vështirësive financiare në këto vite. Në këto kushte, deklaratimet e subjektit për ekzistencën e kësaj huaje mbeten deklarative e një përpjekje e tij për të përmirësuar situatën e tij financiare, duke spostuar ngarkimin me shpenzim për blerjen e kësaj pasurie, nga viti 2006, në të cilin është lidhur kontrata e porosisë, në vitet para 2002-shit, të cilat për më tepër janë vite në të cilat subjekti nuk ka kryer deklarime dhe është i lirë të ndërtojë një skemë krejtësisht në përputhje me interesat e tij financiarë në funksion të procesit të rivlerësimit.

21.7. Në përfundim, lidhur me verifikimin e burimeve të ligjshme të përdorura për financimin e këtij apartamenti, trupi gjykues, pasi analizoi shkaqet e ankimit në këndvështrim të të gjitha të

¹⁵ Sipas shkresës së DRT Lezhë, datë 10.09.2002, e cila është administruar në kuadër të procedimit penal nr. {***} të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

dhënave që kanë rezultuar nga hetimi administrativ, e gjeti të drejtë qëndrimin e Komisionit në drejtim të përcaktimit të faktit se pagesa për shlyerjen e çmimit të përcaktuar në kontratën e porosisë, duhet të ngarkojë me shpenzim ekonominë familjare të subjektit në vitin 2006, kohë në të cilën kjo marrëdhënie ka lindur dhe është materializuar në kontratën formale. Përmbajtja e neneve të kontratës për mënyrën e pagimit të çmimit dhe mungesa e deklarimeve të sakta dhe në kohë të subjektit, në deklarata periodike që për më tepër janë kontradiktore, në shkelje të detyrimeve të parashikuara prej ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, bëjnë të pabesueshëm çdo shpjegim/pretendim për të qartësuar këtë fakt juridik, i cili duhej të kishte gjetur pasqyrim në deklarimet periodike në përputhje me parashikimet ligjore. Pretendimet e subjektit për burimin e financimit të kësaj pasurie, në fillim si nga kursimet e tij dhe të bashkëshortes e më pas nga shlyerja e një detyrimi që kishte pasur ndaj tij, ortaku i shoqërisë ndërtimore, z. L. Rr., mbetën në nivel deklarativ dhe u vlerësuan nga trupi gjykues si të pabesueshme. Për pasojë, trupi gjykues konfirmoi rezultatin financiar të nxjerrë nga Komisioni lidhur me këtë pasuri, në vlerën (-) 2.328.815,32 lekë, dhe konkludoi se subjekti gjendej në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të financuar krijimin e kësaj pasurie dhe përballimin e shpenzimeve nën kualifikimin e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

22. Përveç sa më sipër, trupi gjykues mori në shqyrtim edhe situatën e analizuar nga Komisioni në funksion të konkluzionit se subjekti është gjendur, përveç të tjerave, edhe në një situatë konflikti të interesit në raport me z. Rr., për shkak të ndjekjes së një procedimi penal ndaj tij në vitin 2002, duke u gjendur në këtë mënyrë në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016.

22.1. Lidhur me këtë çështje, nga aktet e administruara gjatë hetimit, konstatohet se Komisioni ka shtrirë hetimin administrativ mbi marrëdhënien e deklaruar prej subjektit dhe të konfirmuar edhe prej vetë z. Rr.¹⁶ se ka ekzistuar prej tyre, qoftë ajo e huadhënies e krijuar para vitit 2002, qoftë ajo e miqësisë e lindur prej shumë vitesh, edhe para vitit 2002. Në funksion të këtij hetimi, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në datën 12.5.2021, me shkresën nr. {***} prot., informon Komisionin se subjekti i rivlerësimit ka hetuar çështjen nr. {***}, me të pandehur z. L. Rr. dhe ka vendosur pushimin e saj në datën 21.2.2003. Nga analizimi i akteve të fashikullit të çështjes nr. {***}, të përcjellë nga kjo prokurori, rezulton se përgjatë hetimit penal të kësaj çështjeje, janë administruar një sërë korrespondencash¹⁷ që evidentojnë emrin e

¹⁶ Sipas deklaratës noteriale¹⁶ nr. {***} rep., e nr. {***} kol., të datës 09.06.2021.

¹⁷ Në fashikullin e çështjes penale nr. {***}, të përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Drejtoria e Shërbimit Pyjor Lezhë, më datë 21.11.2002, ka bërë kallëzim për shtetasin L. Rr., për dëmtim të fondit pyjor.

- Me urdhrin e datës 26.11.2002, subjekti i rivlerësimit Agim Dalipaj, në cilësinë e prokurorit të çështjes nr. {***}, ka urdhëruar pyetjen e shtetasit L. Rr..
- Me procesverbalin e datës 09.12.2002, L. Rr. ka dhënë deklarime në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, të cilat janë mbajtur nga oficeri i policisë gjyqësore E. K..
- Në fashikull gjendet edhe një korrespondencë e shoqërisë “{***}” ShPK me Ministrinë e Ekonomisë, e datës 29.11.2002, e cila është nënshkruar nga administratori i kësaj shoqërie, z. L. Rr..
- Në fashikullin e hetimit të prokurorisë, gjendet dokumenti “Leje teknologjike prodhim materiale ndërtimi” nr. {***}, datë 02.12.2002, me nr. leje {***}, e lëshuar nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për shoqërinë “{***}” ShPK.
- Në këtë fashikull të hetimit penal, është edhe një vërtetim i datës 10.09.2002, i lëshuar nga Drejtoria e Tatim Taksave Lezhë, i cili pasqyron se “{***}” ShPK, me administrator L. Rr., ka bilanc pozitiv për vitet 1999, 2000 e 2001.

shoqërisë “{***}” ShPK, si dhe emrin e pronarit të saj, z. L. Rr., ndaj të cilit është zhvilluar procedimi penal në fjalë, për veprën penale “Për dëmtim të fondit pyjor”, parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal. Nga këto akte, rezulton se më datë 21.02.2003, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, bazuar në nenin 328/a, d të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur pushimin e çështjes nr. {***}, në ngarkim të shtetasit L. Rr..

22.2 Komisioni, duke vlerësuar këtë situatë në raport me marrëdhënien e deklaruar nga vetë palët se ka ekzistuar mes tyre, ka arritur në konkluzionin se subjekti gjendet në kushtet e konfliktit të interesit në kohën e hetimit të procedimit penal ndaj z. Rr., duke e përfshirë këtë konkluzion në rastet e vlerësuar brenda kriterit të vlerësimit të pasurisë dhe që kanë plotësuar situatën e një deklarimi të pamjaftueshëm brenda këtij kriteri.

22.3 Trupi gjykues, pasi analizoi faktet e rezultuara/të pranuar se kanë ekzistuar lidhur me këtë çështje, ndonëse ndan të njëjtin qëndrim me Komisionin në drejtim të situatës faktike, ka një vlerësim të ndryshëm për sa i përket identifikimit të legjislacionit të zbatueshëm në këtë rast, qëndrim i cili e çon në përfundimin se konkluzioni i Komisionit për ekzistencën e konfliktit të interesit është i gabuar dhe i pambështetur në ligj.

22.4 Së pari, referuar deklarimeve të vetë subjektit dhe z. Rr., mes tyre ka ekzistuar një marrëdhënie e ngushtë miqësore në vite, për shkak dhe mbi bazë të së cilës është ndërtuar edhe marrëdhënia e huas mes tyre, e cila kishte nisur që në vitet 1999 e në vazhdim. Ndonëse trupi gjykues, ashtu si edhe Komisioni, nuk pranoi si të provuar këtë marrëdhënie huaje për shkak të mungesës së deklarimeve rreth saj në deklaratat periodike të pasurisë, në zbatim të detyrimeve ligjore për ta bërë këtë dhe për shkak të kontradiktoritetit të deklarimeve rreth burimit të krijimit të pasurisë apartament, nuk mund të bëjë të njëjtin arsyetim për të pranuar si të vërteta deklaratimet e të dyja palëve rreth marrëdhënies miqësore, deklarime të cilat nuk ka qenë e nevojshme të kalojnë nëpër deklarimin para institucioneve për t’u konsideruar të vërteta. Nisur nga kjo predispostë, trupi gjykues pranon si të vërtetë deklarimin e subjektit dhe të z. Rr. mbi ekzistencën e marrëdhënies së tyre miqësore që në vite të hershme, të paktën që prej vitit 1999, sipas deklarimit të tyre. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit gjendej në kushtet e parashikuara prej neneve 17 e 26 të Kodit të Procedurës Penale, sipas përcaktimit të të cilave ai duhej të hiqte dorë prej hetimit të procedimit penal që zhvillohej nga z. Rr., në kushtet e miqësisë së ngushtë.

22.5 Pavarësisht këtij konstatimi, trupi gjykues konstaton se situata faktike ka ekzistuar në vitin 2002 dhe kualifikimi i saj prej Komisionit si një situatë e cila i nënshtrohet legjislacionit për konfliktin e interesit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, gjendet i padrejtë, përderisa ky legjislacion është miratuar prej Kuvendit të Shqipërisë në vitin 2005 dhe nuk ka ndonjë parashikim të posaçëm për efekte prapavepruese. Në këto kushte, referimi që Komisioni ka bërë te neni 33, pika 5, germa “d” e ligjit nr.84/2016, e cila është një dispozitë që evidenton konfliktin e interesit në krijimin e pasurive, nuk mund të aplikohet në rastin konkret përderisa norma nuk ka ekzistuar në kohën e ngjarjes së analizuar.

22.6 Sipas vlerësimit të trupit gjykues, kjo situatë do të ishte e mundur të trajtohej e të analizohej nën dritën e parashikimeve të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji 96/2016”), brenda vlerësimit të kriterit

të aftësive profesionale, por edhe sipas përcaktimeve ligjore që rregullojnë këtë kriter, kjo është e pamundur të kryhet në kushtet kur situata faktike e marrë në analizë, ka ndodhur në vitin 2002, ndërsa kriteri i aftësive profesionale mund t'i nënshtrohet vlerësimit prej organeve të rivlerësimit maksimalisht për ngjarje e sjellje joprofesionale të ndodhur deri në vitin 2006, sipas parashikimit të nenit 42, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

22.7 Për sa më lart, ndonëse provohet se ka ekzistuar një sjellje e papërshtatshme e subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e funksioneve të prokurorit gjatë hetimit penal ndaj shtetasit L. Rr., ajo nuk mund të kualifikohet në ndonjë prej rasteve të përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm që thërret nën përgjegjësi disiplinore subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi.

23 *Lidhur me shkakun e ankimit nëpërmjet të cilit subjekti i rivlerësimit e konsideron si jo të drejtë dhe të saktë analizën që Komisioni ka kryer në funksion të verifikimit të mundësisë së subjektit për të krijuar me burime të ligjshme kreditimet e fondeve që në deklaratën “vetting” janë identifikuar si të përfshira depozitë në shumën 10.000.000 lekë, në Raiffesisen Bank, trupi gjykues analizon sa vijon.*

23.1 Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar depozitë bankare në shumën 10.000.000 lekë. Pjesa takuese 100%, me burim krijimi nga kursimet dhe interesa për vitet 2003-2016. Sipas analizës ekonomike të kryer nga Komisioni, në vitin 2014 subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me një diferencë negative prej (-) 190.000 lekësh, balancë e cila, në zbatim të parimit të proporcionalitetit, nuk është e mjaftueshme që të passjellë zbatimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

23.2 Trupi gjykues, me qëllim shqyrtimin e këtij shkakun ankimi, mori në analizë veprimet e kryera ndër vite në depozitën në Raiffeisen Bank. Nga korrespondenca¹⁸ e përcjellë në Komision prej kësaj banke, rezulton se subjekti ka pasur një llogari bankare pranë saj, nga e cila një pjesë të gjendjeve të likuiditeteve të disponuara i ka kaluar si shtesa në depozitën në të njëjtën bankë, për çdo vit, për periudhën 2006 – 2018. Në datën 19.4.2019, shuma totale prej 12.001.020 lekësh është mbyllur në një depozitë me afat 12-mujor. Nga ana e Komisionit¹⁹, me qëllim identifikimin e burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj depozite, është bërë një analizë përmbledhëse për periudhën 2006-2016, nga e cila, përveç vitit 2006 (kur është instaluar e gjithë blerja e apartamentit në Shëngjin), që rezulton me një balancë negative prej (-) 2.425.787.41 lekësh, konstatohet një diferencë negative dhe në vitin 2014, e cila, pas konsiderimit të shpjegimeve dhe pretendimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar përfundimisht në një vlerë prej (-) 190.000 lekësh.

¹⁸ Me shkresën “kthim përgjigje” të Raiffeisen Bank, me nr. {***} prot., datë 24.1.2020.

¹⁹ Në analizën financiare të përmbledhur nga Komisioni për periudhën 2006-2016, në të cilën janë përfshirë të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes, pasuritë e krijuara, detyrimet financiare, shpenzimet e jetës sipas INSTAT-it, subjekti i rivlerësimit rezulton me një diferencë negative prej (-) 2.425.787 lekësh në vitin 2006, si dhe me një diferencë negative prej (-) 190.000 lekësh në vitin 2014. Për vitet me rezultat negativ, të dhënat e përfshira në analizë, janë si vijon: për vitin 2006, pasuri e krijuar në vlerën 2.859.228 lekë, të ardhura në vlerën 1.407.834 lekë, shpenzime në vlerën 974.393 lekë, rezultati (-) 2.425.787 lekë; për vitin 2014, pasuri e krijuar në vlerën 1.244.969 lekë, detyrime financiare në vlerën 168.000 lekë, të ardhura në vlerën 2.194.422 lekë, shpenzime në vlerën 971.454 lekë, rezultati në vlerën (-) 190.000 lekë.

23.3 Subjekti në ankim, për analizën e kryer nga Komisioni, veçanërisht për vitin 2014 (vit i cili ka rezultuar me një diferencë negative prej (-) 190.000 lekësh), kërkon nga Kolegji të merren në konsideratë argumentet e dhëna prej tij në drejtim të shpenzimeve jetike. Subjekti në ankim pretendon se: *jo vetëm që mesatarja e shpenzimeve jetike për frymë që aplikon në analizën ekonomike Komisioni (siç edhe vetë termi sugjeron), nënkupton marrjen në konsideratë të të gjitha fashave ekonomike të konsumit vjetor, duke filluar që nga më të varfrit e duke përfunduar te më të pasurit dhe nxjerrjen e një mesatareje për to, por se (edhe për shkak të polarizimit të fortë social të shoqërisë sonë), ajo është disa herë më e lartë se kufiri minimal i të ardhurave për frymë dhe i mundësive eventuale të shpenzimit që familjet e varfra kanë. Ndryshe nga sa përpiqet të shtrembërojë Komisioni, mesatarja e shpenzimeve vjetore të nxjerra nga INSTAT-i nuk ka të bëjë me termin "shpenzime bazike" të shpikur nga Komisioni, megjithëse ato përfshijnë edhe nivelin e varfërisë, ato përfshijnë njësoj edhe nivelin më të lartë të shpenzimeve të më të pasurve. Me këtë qëndrim, subjekti në thelb pretendon se shpenzimet jetike që aplikon në analizë Komisioni, nuk përfaqësojnë shpenzimet bazike që, si të tilla, mund të konsiderohen si dyshemeja nën të cilën nuk mund të argumentohet/pretendohet përveçse mbi prova shkrese.*

23.4 Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmon se Komisioni me të drejtë ka arsyetuar në vendim se shpenzimet e arsimit privat nuk mund të zbriten nga analiza financiare pasi ato nuk mund të argumentohen se janë pjesë e shpenzimeve bazike të jetesës. Në këto kushte, rezulton se ky shërbim (për arsimim) në Republikën e Shqipërisë ofrohet me shpenzime modeste nga institucionet publike dhe i njëjti shërbim i ofruar nga biznese private është në mënyrë përkufizuese përtej nivelit bazik të jetesës së marrë për bazë në përlllogaritjet e institucioneve të rivlerësimit sipas informacionit të sjellë nga INSTAT-i.

23.5 Nga sa më sipër, trupi gjykues konstaton se çështja e shpenzimeve të jetesës është një argument jo vetëm i trajtuar në vendimin e Komisionit, por gjendet edhe i mirargumentuar dhe i bazuar në logjikën ekonomike e sensin e përgjithshëm. Në të tilla kushte, për efekt të kontrollit të analizës së kryer prej Komisionit, trupi gjykues çmon se nuk mund të ndryshojë shpenzimet jetike të përdorura prej tij, të cilat aplikohen dhe përdoren si të tilla, edhe në metodologjinë që Kolegji aplikon për përlllogaritjen e kostove të jetesës së subjekteve të rivlerësimit.

23.6 Në këto kushte, trupi gjykues konfirmon se analiza financiare e vitit 2014, e kryer nga Komisioni, mbetet e pandryshuar, në një balancë negative prej (-) 190.000 lekësh, e cila i shtohet në analizë balancës negative të vitit 2006, në vlerën prej (-) 2.425.787,41 lekësh, duke rezultuar në total në kushtet e mungesës në burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve për periudhën 2003-2016, në vlerën prej 2.615.787 lekësh, situatë që kualifikohet sipas nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016.

23.7 Në përmbledhje dhe konsideratë të konkluzioneve të mësipërme, trupi gjykues arriti në përfundimin se është i drejtë qëndrimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke u gjendur nën kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqe ankimi që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

- 24 Trupi gjykues mori në analizë shkaqet e ankimit të ngritura prej subjektit të rivlerësimit në raport me konkluzionet e Komisionit për çështjet e trajtuara në vendim në kuadër të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, në këndvështrim të të dhënave që vijnë nga aktet e administruara dhe në raport me ligjin e zbatueshëm. Analiza e këtyre çështjeve në vijim do të kryhet sipas strukturës së përcaktuar në vendimin e Komisionit dhe mbi të cilën është adresuar edhe ankimi i subjektit, dhe që i referohet grupit të dokumenteve ligjore të depozituara prej subjektit, grupit të çështjeve të ekstraktuara për kontroll sipas një shorti rastësor dhe grupit të çështjeve për të cilat hetimi i Komisionit ka nisur mbi bazën e denoncimeve të publikut dhe ankesave të paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit.
- 25 Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit, me anë të të cilit ai kundërshton *si jo të drejta dhe të bazuara në ligj konkluzionet e Komisionit mbi vlerësimin e akteve ligjore të dorëzuara prej subjektit mbi bazën e shtojcës nr. 3 të ligjit nr. 84/2016, që kanë të bëjnë me: (i) vendimin për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***} të vitit 2016; (ii) kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2015; (iii) kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2013, për të cilat u konstatua dhe analizua sa vijon.*

25.1 Lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2016 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në vendimin e Komisionit është konkluduar se: *Lidhur me vendimin e datës 28.08.2016, për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***}, datë 30.05.2016, në ngarkim të shtetases Z. I., për veprën penale "Shpërdorim detyre", të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, [...] Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Nga përmbajtja e dokumentit kërkesë për gjykim, konstatohet se konkluzionet paraqiten me një strukturë jo të qartë dhe të kuptueshme. Subjekti nuk ka parashtruar në mënyrë të detajuar rrethanat e faktit, ndërkohë që ka paraqitur në mënyrë të hollësishme pohimet e dëshmitarëve, çka nuk është e nevojshme dhe nuk kërkohet nga neni 331/2 i Kodit të Procedurës Penale për përpilimin e kërkesës për gjykim. Komisioni çmon se në këtë dokument ligjor, subjekti ka treguar njohuri dhe gjykim të dobët, pasi evidentohen mangësi në arsyetimin e kërkesës për gjykim, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pika 3 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".*

Në ankim për vendimin e pushimit të procedimit penal nr. {***} të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit në mënyrë të përmbledhur, pretendon se:

(i) Lidhur me strukturën e vendimit të pushimit të hetimeve: [...] *nga eksperiencia dhe njohjet e mia, jam plotësisht i sigurt se pjesa dërrmuese e vendimeve të pushimit të kësaj periudhe të kolegëve prokurorë në vendin tonë, në mos më të dobët, kanë të njëjtën strukturë formale, të njëjtën formë të parashtrimit të fakteve, të njëjtin nivel analize të shtjellimit të fakteve dhe ligjit të zbatuar, sikurse ajo e ndjekur nga unë në këtë vendim, por nuk janë konsideruar nga Komisioni se kanë treguar "aftësi dhe gjykim të dobët", sikurse unë.*

(ii) Lidhur me arsyetimin e vendimit: *çështja e arsyetimit të vendimeve gjyqësore (në rastin konkret të vendimit të pushimit të prokurorisë), kërkon si standard që ai të jetë i kuptueshëm dhe i qartë, por nuk kërkon domosdoshmëri në çdo rast një trajtim të detajuar dhe të thellë të përjasjes së faktit me ligjin.*

iii) Lidhur me strukturën e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. {***}: në vendimin tim për pushimin e hetimeve është bërë një përshkrim i detajuar i faktit penal, por ndryshe nga sa pretendon Komisioni, ai është bërë përmes paraqitjes kronologjike të provave të marra në këtë hetim. [...] Më poshtë kam parashtruar veprimet hetimore, siç janë deklaratimet e dëshmitarëve për çfarë ata kanë pasur dijeni dhe shkeljet e konstatuara prej tyre, administrimi i provave shkresore, të gjetura nga hetimi, si: në Bashki, KLSH dhe DRTT Kurbin. Në fund kam parashtruar rezultatet e hetimit për të gjitha shkeljet e pretenduara nga kallëzuesi dhe në fund kam thënë nuk kemi shkelje që të përbëjë vepër penale.

(iv) Lidhur me paraqitjen e fakteve të procedimit penal: Paraqitja e fakteve të një hetimi penal është vështirë që të bëhet me objektivizëm, duke e paraqitur faktin penal më vete, si një përshkrim kategorik dhe të provuar, pa e shoqëruar atë me provat nga të cilat burojnë ato informacione, pasi në të vërtetë është e qartë se rezultatet e hetimit penal jo vetëm që nuk janë kategorike dhe plotësisht të sigurta, por shpesh herë konsiderohen si të gabuara nga gjykata. Në këtë sens, mënyra më e mirë dhe objektive për t'i parashtruar gjykatës, palëve dhe audiencës së lexuesve mënyrën e ndodhjes së një fakti penal (apo në rastin e pushimit një fakt jopenal), është përmes përshkrimit të të dhënave që dalin nga provat e marra në atë hetim [...]. Prandaj, në rastin e vendimit të pushimit të procedimit nr. {***}, jo vetëm nuk mund të thuhet se nga ana ime nuk është paraqitur fakti penal (i dyshuar), por përkundrazi, ai është paraqitur i plotë dhe i detajuar. Meqë në këtë fazë të ankimit jemi te profesionalizmi dhe skrupoloziteti, edhe sikur konkluzionet e Komisionit të ishin të vërteta, me qëllim vënien në jetë të atyre parimeve që pretendohet se kam shkelur, do të ishte dashur që së paku me një fjali të kishin përshkruar konkretisht se cilat fakte të rëndësishme nuk kam pasqyruar në këtë vendim.

(v) Subjekti gjithashtu i kundërshton edhe konkluzionet e Komisionit për mosanalizim të elementeve të veprës penale të shpërdorimit të detyrës, duke pretenduar se: pasi, megjithëse nuk është bërë një analizë e detajuar e kësaj figure krimi, nga ana ime janë analizuar elementet procedurale të cilat nuk lejonin vijimin e këtij procedimi. Përshkrimi i qartë i arsyeve se ky procedim penal nuk duhet të vijonte, janë më se të mjaftueshme për t'u bërë të ditur palëve ligjshmërinë e kësaj vendimmarrjeje.

(vi) Lidhur me konstatimin e Komisionit se vendimi i pushimit të procedimit penal nuk është i argumentuar, e kundërshton duke shprehur se: të njëjtat komente vlejné edhe për përfundimin e Komisionit se vendimi i pushimit nuk është i argumentuar qartë dhe në mënyrë të plotë, pasi ky përfundim në vetvete është i paargumentuar se çfarë elementi esencial i mungon arsyetimit të këtij vendimi. Për më tepër, është e papranueshme që Komisioni të konsiderojë si të paarsyetuar një vendim prokurorie i cili lihet në fuqi nga gjykata dhe për më tepër që i njëjti arsyetim i prokurorisë, përdoret edhe nga gjykata. Vendimi i gjykatës mbi këtë çështje ka marrë formë të prerë më datë 06.11.2020 dhe Komisioni nuk i ka marrë fare në konsideratë këto fakte.

25.2 Trupi gjykues, nga analizimi i akteve të fashikullit administrativ, konstaton se konkluzionet e vendimit të Komisionit që kanë të bëjnë me analizimin e vendimit të marrë nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes për pushimin e hetimeve të procedimit nr. {***} të vitit 2016, janë të njëjta me konkluzionet e raportit të grupit të punës së Prokurorisë së Përgjithshme. Në këtë kuptim, kjo e dhënë duket se i jep përgjigje pretendimit të subjektit se vlerësimi i tij profesional nga Komisioni, është vlerësuar nga një trupë jo e kualifikuar, përderisa edhe një trupë e kualifikuar, sipas vlerësimit të subjektit, ka evidentuar të njëjtat defekte.

25.3 Në analizë, për t'i dhënë përgjigje këtij shkaku ankimi, është marrë vendimi i prokurorit për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***}, si dhe vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë nr. {***}, datë 22.10.2020, për shqyrtimin e kërkesës penale me objekt "Pushimin e gjykimit të procedimit penal nr. {***} të vitit 2016, për veprën penale "Shpërdorim detyre", e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal".

25.4 Nga analizimi i këtyre dy akteve, në kundërshtim me sa parashtron në ankim subjekti, trupi gjykues vëren se në mënyrë të dukshme rezultojnë që struktura e vendimit të gjykatës dhe ajo e vendimit të prokurorit për pushimin e hetimeve janë tërësisht të ndryshme, konkretisht: struktura e vendimit të gjykatës ka në mënyrë të qartë të evidentuara: i) rrethanat e faktit; ii) veprimet hetimore të kryera; iii) dëshmitarët e pyetur dhe provat e marra; iv) ligjin e aplikueshëm; dhe v) vlerësimin e gjykatës. Ndërsa struktura e vendimit të prokurorit për pushimin e hetimeve të procedimit {***} është e ndërtuar vetëm mbi një renditje të dhënash, në të cilat është e vështirë të ekstrahohen rrethanat e faktit, të evidentohen provat e marra, faktet që provon secila prej tyre dhe analiza e vlerës provuese të çdo prove. Në vendimin e pushimit evidentohet të mungojë analiza ligjore për elementet e veprës penale, baza ligjore në të cilën mbështet arsyetimi dhe zgjidhja e çështjes. Nga vëzhgimi i këtij dokumenti, konstatohet se ndonëse subjekti rendit deklarimet e personave që kanë dhënë deklarime në cilësinë e personave që kanë dijeni për rrethanat e çështjes, ato vetëm janë hedhur në mënyrë fotografike, përmbajtjes së secilit prej këtyre deklarimeve i mungon analiza dhe ndikimi që ato kanë në zgjidhjen e çështjes, si edhe një analizë e integruar dhe e harmonizuar e secilit deklarim në raport njëri me tjetrin. Vendimi shoqërohet nga gabime të shumta drejtshkrimore të një niveli që rrezikojnë edhe leximin e qartë e të kuptueshëm të aktit. Trupi gjykues vlerëson gjithashtu të gabuar përdorimin nga subjekti të bazës ligjore të parashikuar nga neni 328, germa "a" dhe "b" të Kodit të Procedurës Penale²⁰. Situatat e parashikuara në këto dy germa të kësaj dispozite, përjashtojnë njëra-tjetrën dhe nuk mund të kualifikojnë njëkohësisht të njëjtën situatë faktike të rezultuar nga hetimi. Në këtë kuptim, arsyetimit të vendimit i ka humbur edhe qartësia ligjore mbi konkluzionin e arritur.

25.5 Për sa i përket plotësisë së veprimeve hetimore të kryera në drejtim të zbardhjes të së vërtetës, rezultojnë se vendimi i pushimit të hetimeve i marrë prej subjektit në gusht të vitit 2016, është prishur nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. {***}, datë 20.12.2017, e cila ka vendosur vazhdimin e hetimeve ndaj shtetas Z. I., duke arsyetuar se nga ana e prokurorisë nuk është analizuar mirë rezultati i hetimeve dhe pretendimet e palës kallëzuese (Bashkia Tropojë), duke mos bërë mirë analizimin e saktë të fakteve dhe provave. Në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë nr. {***}, datë 22.10.2020, evidentohen veprimet hetimore që janë kryer në vijim, pra pas prishjes së vendimit të marrë prej subjektit të rivlerësimit, për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***}. Në këto kushte, konstatohet edhe fakti se nga kontrolli gjyqësor mbi vendimmarrjen e prokurorit, janë evidentuar të meta e mangësi të cilat kanë detyruar gjykatën të urdhërojë vijimin e mëtejshëm të hetimeve.

25.6 Për sa më sipër, rezultojnë se pretendimet e subjektit lidhur me vendimin e pushimit të hetimeve për procedimin {***}, trupi gjykues çmon jo vetëm që nuk mund të ndryshojnë konkluzionet e Komisionit për këtë çështje, por ato potencojnë konkluzionin për evidentimin e

²⁰ Germa "a" dhe "b" të Kodit të Procedurës Penale: "[...] a) del qartë se fakti nuk ekziston; b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale".

mangësive të subjektit në drejtim të kriterit të aftësive profesionale, aq më tepër kur ato konstatohen edhe në një akt të servitur prej vetë atij, me synimin e provimit të një niveli të lartë të formimit të tij profesional.

25.7 Për sa u përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit me anë të të cilave kundërshton konkluzionet e Komisionit lidhur me kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2013, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, të shtetasit P. D., për veprën penale “Vrasje me paramendim” dhe “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake”, me pasojë vdekjen e shtetasit M. J., trupi gjykues konstaton dhe analizon sa vijon.

25.8 Në vendimin e Komisionit për këtë dokument, është konkluduar se: *pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Në faqen 3 të dokumentit “Kërkesë për gjykim”, gjendet deklarimi i shtetasit F. N. (punonte si çoban për llogari të viktimës), i cili, ndër të tjera, ka deklaruar se gjatë kohës që ka kullotur bagëtitë e M. në fshatin Gj., rreth 20 minuta larg nga shtëpia e tij në këmbë, ka qenë e mbjellë një parcelë me bimë narkotike canabis sativa, të cilën ka parë që e vadisnin F. (P.) i pandehuri dhe gruaja e parë e M. (viktimës) [...] ka parë F. (P.) duke mbushur një thes me bimë narkotike canabis sativa. Bazuar në deklaratimet e këtij shtetasi, subjekti duhet të kishte zgjeruar hetimet dhe, për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, veprim i cili nuk është kryer prej tij. Në lidhje me përmbajtjen e dokumentit “Kërkesë për gjykim”, konstatohet se konkluzionet paraqiten me një strukturë jo të qartë dhe të kuptueshme. Subjekti nuk ka parashtruar në mënyrë të detajuar rrethanat e faktit, ndërkohë që ka paraqitur në mënyrë të hollësishme pohimet e dëshmitarëve, çka nuk është e nevojshme dhe nuk kërkohet nga neni 331/2 i Kodit të Procedurës Penale për përpilimin e kërkesës për gjykim.*

Komisioni çmon se në këtë dokument ligjor, evidentohet se subjekti ka treguar aftësi, njohuri, gjykim të dobët, pasi evidentohen: (i) mangësi në drejtim të hetimit të plotë të çështjes dhe hetim i dobët nga subjekti; (ii) mangësi në arsyetimin e kërkesës për gjykim, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

25.9 Në ankim, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit lidhur me këtë dokument, duke pretenduar se Komisioni ka synuar të njollosë emrin e tij nëpërmjet konkluzioneve të gabuara dhe të njëjta për të gjitha çështjet e marra në analizë. Qëndrimi i Komisionit se subjekti nuk duhej të kishte paraqitur në kërkesën për gjykim deklaratimet e dëshmitarëve, bie ndesh me parashikimet e nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale dhe konfundohen me ndalimin për bashkëlidhjen e dosjes gjyqësore të procesverbaleve të deklaratimeve të personave që pyeten gjatë hetimit. Subjekti ka kundërshtuar edhe qëndrimin e Komisionit se ai nuk kryer veprimtarinë hetimore për verifikimin e informacionit se i pandehuri kishte kultivuar bimë narkotike, duke pretenduar se hetimi rreth kësaj të dhëne ishte vlerësuar i panevojshëm dhe i pamundur për shkak të mosgjatjes së gjurmëve të kryerjes së veprës.

25.10 Siç është evidentuar më sipër, edhe për dokumentin “Kërkesë për gjykim të procedimit penal {***}”, të përcjellë nga subjekti me qëllim vlerësimit të aftësive profesionale sipas kërkesave të neneve 43 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues sërish vëren se konkluzionet e vendimit të Komisionit janë kryesisht të bazuara në konkluzionet e vlerësimit të aftësive

profesionale për këtë dokument nga struktura e specializuar, Grupi i Punës i Prokurorisë së Përgjithshme, i hartuar nga prokurorë në karrierë.

25.11 Lidhur me elemente të formës dhe përmbajtjes së dokumentit, edhe ky trup gjykues konstaton, ashtu si Komisioni, se kërkesa për gjykim gjendet e paarsyetuar, nuk ka një analizë të fakteve që kanë rezultuar nga provat e mbledhura gjatë hetimit dhe as një analizë të tyre në funksion të përcaktimit të faktit penal. Në kërkesën për gjykim, mungon tërësisht analiza e faktit penal në funksion të kualifikimit të tij si “Vrasje me paramendim” dhe jo “Vrasje e thjeshtë”. Subjekti nuk ka argumentuar në këtë dokument përse veprimet e të pandehurit duhen kualifikuar në këtë mënyrë. Nuk rezulton asnjë motiv apo qëllim i zbardhur nga hetimi për shkak të të cilit rezulton të jetë kryer vepra penale sipas një kualifikimi të tillë, në kundërshtim me kërkesat e nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale.

25.12. Ndër të tjera, përpos sa më lart, në vendimin e Komisionit për këtë çështje, është evidentuar se nga të dhënat e fashikullit të hetimit penal, rezulton se subjekti ka marrë dëshmi që informojnë se i pandehuri po kultivonte lëndë narkotike *canabis sativa* dhe nisur nga kjo e dhënë, Komisioni ka mbajtur qëndrimin se *subjekti duhet të kishte zgjeruar hetimet dhe për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, veprim i cili nuk është kryer prej tij.* Ky fakt i evidentuar nga Komisioni, ka qenë pjesë e deklarimeve të personave të pyetur në kuadër të këtij procedimi penal, dhe nga aktet në dosje nuk rezulton që organi i prokurorisë, nëpërmjet prokurorit, subjektit të rivlerësimit, të ketë kryer ndonjë veprim hetimor në drejtim të verifikimit të këtij informacioni. Subjekti nuk ka mundur të shpjegojë as në hetim dhe as në ankim, përse nuk ka zgjeruar hetimet në drejtim të veprës tjetër penale, asaj të kultivimit të lëndëve narkotike. Ai shpjegon se ky veprim nuk ishte i justifikuar, meqenëse të akuzuarit nuk iu gjetën në banesë gjurmë të lëndëve narkotike dhe se në këtë rast, hetimi duke pyetur dëshmitarë, do të ishte i pavlerë. Në vlerësimin e trupit gjykues, konstatimi i Komisionit se subjekti duhej të kishte kryer veprimtari hetimor për të verifikuar informacionin e dalë nga hetimi se i pandehuri kishte kultivuar lëndë narkotike, nëpërmjet këqyrjes së parcelës së identifikuar për këtë qëllim dhe jo të qëndronte krejtësisht pasiv drejt verifikimit të një informacioni për kryerjen e një vepre penale, gjendet i drejtë dhe tregon se subjekti nuk ka kryer në lartësinë e detyrës veprimtarinë hetimorë, duke lënë jashtë hetimit një të dhënë që mund të kishte prodhuar vënien para përgjegjësisë së personave të dyshuar edhe për një veprimtari kriminale tjetër. Sjella pasive e prokurorit në këtë rast, vlerësohet si një mangësi në kryerjen e detyrës, e cila me gjasa ka lehtësuar edhe pozitën e të pandehurit, duke shkaktuar shmangien e tij nga përgjegjësia për këtë vepër.

25.13 Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit me anë të të cilave kundërshton konkluzionet e Komisionit lidhur me kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2015 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, në ngarkim të të pandehurit Q. D., për veprën penale të “Shkeljes të rregullave të mbrojtjes në punë”, të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal, me pasojë vdekjen e A. H., trupi gjykues analizon sa vijon.

25.14 Në vendimin e Komisionit për këtë kërkesë për gjykim, të hartuar në cilësinë e prokurorit nga subjekti i rivlerësimit, është konkluduar se: [...] *pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Nga përmbajtja e dokumentit “Kërkesë për gjykim”, konstatohet se konkluzionet paraqiten me një strukturë jo të qartë dhe të*

kuptueshme. Subjekti nuk ka parashtruar në mënyrë të detajuar rrethanat e faktit, ndërkohë që ka paraqitur në mënyrë të hollësishme pohimet e dëshmitarëve, çka nuk është e nevojshme dhe nuk kërkohet nga neni 331/2 i Kodit të Procedurës Penale për përpilimin e kërkesës për gjykim. Komisioni çmon se në këtë dokument ligjor, subjekti ka treguar njohuri dhe gjykim të dobët, pasi evidentohen mangësi në arsyetimin e kërkesës për gjykim, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pika 3 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

25.15 Trupi gjykues, lidhur me këtë dokument ligjor të paraqitur prej vetë subjektit, konstaton sërish se konkluzionet e Komisionit për mangësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit janë të njëjta me ato të grupit të punës në Prokurorinë e Përgjithshme. Gjithashtu, konstatohet se subjekti i rivlerësimit edhe lidhur me këto konkluzione, ngre përgjithësisht të njëjtat kundërshti si ato të ngritura lidhur me procedimin nr. {***} të arsyetuar më lart, edhe për shkak të faktit se konstatimet e Komisionit lidhur me këtë procedim janë po ashtu të njëjta me ato të procedimit tjetër. Subjekti ka pretenduar se duhet konsideruar në vlerësimin e kësaj çështjeje, disponimi në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë nr. {***}, datë 23.03.2016, që ka marrë në shqyrtim këtë çështje.

25.16 Nga një lexim i thjeshtë i vendimit gjyqësor të depozituar prej vetë subjektit dhe që ka marrë në shqyrtim kërkesën e tij për gjykimin e procedimit penal në fjalë, konstatohet se është bërë një analizë në vështrim të anës objektive dhe subjektive të kësaj figure krimi, e cila mungon në kërkesën e prokurorit. Ndërsa nga vëzhgimi i dokumentit ligjor “Kërkesë për gjykim”, konstatohet si në rastet më sipër arsyetuar se mungon një pasqyrim i plotë i rrethanave të faktit dhe ndërtimit të faktit penal, ashtu siç ka rezultuar nga hetimi. Në këtë dokument gjenden të pasqyruara në mënyrë fotografike deklarime të personave që kanë deklaruar me cilësinë e personave që kanë dijeni për rrethanat e ngjarjes, pa i analizuar ato dhe duke e vënë lexuesin në pamundësi për të kuptuar se cilat janë faktet që provohen nëpërmjet tyre. Konstatohet gjithashtu si një element i formës, por edhe i përmbajtjes, mungesa e analizës së bazës ligjore të përdorur, e cila rregullon marrëdhëniet e prekura për të cilat janë zhvilluar hetimet dhe është vendosur të dërgohet në gjyq çështja penale. Mungesa e këtyre elementeve e bën dokumentin të vijë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale.

25.17 Trupi gjykues, edhe në këtë rast, duke mbajtur sërish në vëmendje që kërkesa për gjykimin e këtij procedimi penal është një akt i dërguar nga vetë subjekti për vlerësimin e aftësive të tij profesionale, konkluzionet e grupit të punës së Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe vendimin e Komisionit, sipas të cilit në këtë dokument ligjor subjekti ka treguar njohuri dhe gjykim të dobët, pasi evidentohen mangësi në arsyetimin e kërkesës për gjykim, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pika 3 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në të njëjtin konkluzion dhe, për pasojë, pretendimet e subjektit mbeten të pabazuara.

25.18 Trupi gjykues i gjeti të pabazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me vlerësimet e Komisionit. Fakti që Komisioni në këtë dokument, ashtu si edhe në akte të tjera të hartuara prej subjektit, konstaton të njëjtat mangësi të tij, që lidhen kryesisht me tipologjinë e mungesës së arsyetimit, nuk vlerësohet si një konkluzion i përsëritur i Komisionit, por si një sjellje tipike dhe e përsëritur, me mangësi e subjektit të rivlerësimit, e cila do të vlerësohet në kuadër të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale.

25.19 Në përfundim të analizës së konkluzioneve të Komisionit në raport me tri dokumentet ligjore të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se ato përfaqësojnë në terma të përgjithshëm standardin dhe metodologjinë e subjektit të përdorur për të arsyetuar aktet e përpiluara prej tij në cilësinë e prokurorit. Sipas këtij vlerësimi, me të drejtë Komisioni ka konkluduar për mungesë të arsyetimit në këto akte, si dhe për mosrespektim të strukturës formale, por edhe përmbajtësore të aktit sipas parashikimit të ligjit procedural penal. Trupi gjykues vlerësoi se për shkak të mangësive të konstatuara kryesisht në këtë drejtim, lidhur me këto dokumente ligjore, me të drejtë Komisioni ka konkluduar se subjekti ka reflektuar njohuri dhe gjykim të dobët, duke afektuar indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

26 Trupi gjykues gjithashtu mori në shqyrtim edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, me të cilat kundërshtoi, *duke i konsideruar si jo të drejta dhe të bazuara në ligj, konkluzionet e vendimit të Komisionit lidhur me vlerësimin e dosjeve penale të zgjedhura me short që i përkasin: (i) vendimit, datë 26.01.2015, “Për pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. {***}, të vitit 2014; dhe (ii) vendimit, datë 27.01.2016, “Për pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2015.*

26.1 Në vendimin e Komisionit lidhur me vendimin e datës 26.01.2015, për pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. {***} të vitit 2014, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, është konkluduar se: *Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Në lidhje me këtë procedim, konstatohet se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme. Nga ana e tij, nuk është kryer asnjë veprim hetimor për një periudhë 6-mujore dhe më pas është vendosur pushimi i procedimit, duke zvarritur në këtë mënyrë hetimet pa arsye. Subjekti nuk analizon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme elementet e veprës penale të falsifikimit të dokumentit. Ai nuk ka arritur të analizojë dhe argumentojë qartësisht arsyet e mungesës së elementeve të veprës penale të falsifikimit të dokumenteve. Gjithashtu, konstatohet mospërputhje logjike midis bazës ligjore, normës procedurale mbi të cilën prokurori mbështet vendimin e pushimit të procedimit penal dhe argumenteve të parashtruara në pjesën arsyetuese të vendimit.*

Komisioni çmon se në lidhje me këtë dosje penale, subjekti ka treguar aftësi, njohuri dhe gjykim të dobët, pasi evidentohen: (i) mangësi në drejtim të hetimit të plotë të çështjes dhe hetim i dobët nga subjekti; (ii) mangësi në arsyetimin e vendimit të pushimit; si dhe (iii) zvarritje pa arsye të procedimit penal, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të neni 73 dhe pika 4 e nenit 74 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

26.2 Në ankim, subjekti i rivlerësimit lidhur me këto konkluzione të Komisionit, pretendon se: *(i) Sa u përket atyre që kanë të bëjnë me mosparaqitjen e faktit penal dhe të arsyetimit të vendimit (për të mos rënë në përsëritje), vlejné argumentet parimore të paraqitura më lart për vendimet e tjera (pasi përfundimet e Komisionit janë copy-paste dhe vuajnë nga të njëjtat gabime parimore). (ii) Sa i përket përfundimit të Komisionit se pushimi i çështjes sipas pikës "b" të nenit 328 të K.Pr.Penale, është i gabuar, më duhet të prapësoj se ky përfundim është i gabuar. Në rastin në shqyrtim kemi të bëjmë me dyshime për përdorim të një kontrate në formë fotokopjeje, me tekst të ndryshuar. Duke qenë se fotokopja nuk është dokument me vlerë ligjore,*

atëherë ndryshimi i përmbajtjes së saj nuk përben vepër penale. Arsyetimi im për këtë përfundim është i qartë dhe, ndodhur në kushte të tilla, nuk ka asnjë sens që të thellohen hetimet për një fotokopje, kur nuk ka asnjë dokument origjinal apo të motorizuar me përmbajtje të falsifikuar të përdorur në këtë rast. (iii) Në lidhje me pretendimet për moskryerje për 6 muaj të veprimeve hetimore, ai nuk është fare i vërtetë, pasi kjo çështje nuk ka qenë e imja, por e një prokurori tjetër, i cili për arsye shëndetësore nuk është paraqitur në punë. Gjithsesi, duke mos pasur emra të personave nën hetim të regjistruar, ajo nuk ka afate për hetimin e saj dhe gjatë kësaj periudhe nuk është e domosdoshme kryerja e veprimeve nga prokurori, pasi më parë i kanë caktuar detyra OPGj-së për t'i kryer. Për rrjedhojë, as ky pretendim nuk qëndron, dhe sikur të qëndronte, nuk ka sjellë ndonjë pasojë.

26.3 Trupi gjykues, në analizë të këtyre prapësimeve të ankimit të subjektit për çështjen penale nr. {***} të vitit 2014, edhe në këtë rast, ashtu si edhe në rastet e tjera të analizuara më sipër, subjekti i rivlerësimit, në vendimin për pushimin e këtij procedimi penal, është mjaftuar me pasqyrimin e detajuar të dëshmive të dhëna nga dëshmitarët dhe nuk ka bërë një analizë të plotë të situatës faktike në raport me dispozitat ligjore të aplikuara, të cilat e kanë çuar atë në marrjen e vendimit. Edhe në këtë rast, mungon një evidentim i qartë i akteve të analizuara e të marra në cilësinë e provës, mbi të cilat, përveç dëshmive, është bazuar marrja e vendimit të pushimit të procedimit penal, pasi nga përmbajtja e vendimit, duket se subjekti është mjaftuar vetëm me citim të akteve, pa shpjeguar nëse janë marrë në cilësinë e provës, si janë siguruar etj. Në rastin e procedimit nr. {***} të vitit 2014, citimi i akteve të marra në cilësinë e provës ka rëndësi, pasi rezulton se kjo çështje është regjistruar për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

26.4 Në vendimin për pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2014, subjekti ka konkluduar, ndër të tjera, se pretendimet e kallëzuesit S. A. për sa i përket shkeljes së aktmarrëveshjes nga shoqëria “{***}” ShPK, janë të karakterit administrativo-civil dhe në lidhje me to, ai duhej t’i drejtohej gjykatës, është një konkluzion që tejkalon kompetencat e tij si prokuror i çështjes, i cili po në këtë vendim, është shprehur se e ka të pamundur të provojë shkencërisht, me akt ekspertimi grafik, që aktmarrëveshja me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., e datës 10.04.2000, është falsifikuar. Gjithashtu, në vendimin e pushimit të procedimit penal, subjekti nuk evidenton asnjë veprim hetimor të ndërmarrë prej tij për të siguruar kopjen origjinale të aktmarrëveshjes me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., të datës 10.04.2000, dhe as bën një analizë të historikut të aktmarrëveshjeve që kanë lidhur ndër vite shoqëria “{***}” ShPK me shoqërinë “{***}” ShPK.

26.5 Trupi gjykues, për sa i përket pretendimit të subjektit se: *në lidhje me pretendimet për moskryerje për 6 muaj të veprimeve hetimore, nuk është fare e vërtetë pasi kjo çështje nuk ka qenë e imja, por e një prokurori tjetër, i cili për arsye shëndetësore nuk është paraqitur në punë*, konstaton se nëse i referohemi përmbajtjes së vendimit të Komisionit, rezulton se në të është shprehur qartë se: *Me vendimin, datë 27.6.2014, drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka zëvendësuar prokurorin A. A. “nga kryerja e hetimeve të çështjes penale nr. {***}, viti 2014, duke caktuar prokurorin Agim Dalipaj”.* Rezulton se subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor deri në datën 26.1.2015, kur ka vendosur pushimin e çështjes pa kryer asnjë veprim hetimor, me argumentin se nuk mund të provohet se nga cili person është falsifikuar dokumenti i aktmarrëveshjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë

10.4.2000. Nisur nga ky konkluzion i vendimit të Komisionit, pretendimi i subjektit mbetet i pabazuar.

26.6 Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se pretendimet e ankimit të subjektit të rivlerësimit për kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit për procedimin penal nr. {***} të vitit 2014, nuk qëndrojnë, pasi ato gjenden të pabazuara në situatën faktike dhe në ligj.

26.7 Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit me të cilat kundërshton konkluzionet e vendimit të Komisionit që i përkasin vendimit të datës 27.01.2016, “Për pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2015”, për veprën penale “Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, të parashikuar nga neni 298/1 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve A. H., E. M. dhe F. L., trupi gjykues konstaton dhe analizon sa vijon.

26.8 Në vendimin e Komisionit për procedimin penal me nr. {***} të vitit 2015 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, është konkluduar se: Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Nga analizimi i fashikullit penal, konstatohet se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme. Në vendimin e pushimit, por edhe në parashtrime, pretendon se nga i ndjeri është shkelur urdhri i punës, ndërkohë që ky urdhër mungon. Subjekti nuk ka argumentuar se ku është bazuar që i ndjeri ka shkelur urdhrin e punës, ndërkohë që pranon vetë që ky urdhër pune mungon. Subjekti nuk argumenton se pse nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, por deklaron se ai mendonte se hetimi ka qenë i plotë, ndërkohë që ka pranuar që ky hetim nuk ka qenë i plotë. Subjekti nuk ka hetuar faktin se pse punonjësit kanë punuar në ditë pushimi dhe në mungesë të drejtuesit teknik të shoqërisë “{***}” ShPK. Subjekti pretendon se ekspertë të fushës kanë refuzuar të kryejnë ekspertimin, por ndërkohë në dosje nuk gjendet asnjë urdhër riekspertimi apo refuzimi i ekspertëve të fushës për të kryer ekspertimin. Në lidhje me faktin që emri i të ndjerit ishte në policën e sigurimit, nuk vërteton faktin se ai ka qenë i deklaruar në organet tatimore. Subjekti ka administruar disa listëpagesa, por jo të gjitha, dhe pikërisht listëpagesat e periudhës në të cilën ka ndodhur aksidenti. Në lidhje me afatin e lejes së zjarrmëtarit, subjekti pretendon se është 10 vjet, ndërkohë në lejen e lëshuar në emër të të ndjerit, në pikën 4 të saj citohet se dëshmia është e vlefshme për 5 vjet. Komisioni çmon se në lidhje me këtë dosje penale, duke marrë në konsideratë faktin se kishim të bëjmë me pasoja të rënda, vdekjen e të ndjerit, jemi përpara gabimeve thelbësore dhe serioze që tregojnë mungesë të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, pasi: (i) nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të cilësuarra më lart – në këto rrethana, kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht shkaqet e aksidentit, subjekti duhej të vazhdonte hetimet dhe pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes; (ii) subjekti nuk analizon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme elementet e veprës penale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë; (iii) vendimi i pushimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jobindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështetet në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

26.9 Në ankim, subjekti i rivlerësimit, për procedimin penal me nr. {***} të vitit 2015, parashtron se: Në lidhje me përfundimet e mësipërme të Komisionit (duke dashur të mos bie në përsëritje), prapësoj se, sa u takon gjetjeve në lidhje me paraqitjen e fakteve, qartësinë e

vendimit dhe arsytimit të tij, vlejshëm të njëjtat argumente parimore të dhëna më lart për çështjet e tjera. As për këtë çështje, përveç vullnetit të tij për të përdorur të njëjtin standard voluntarist vlerësues, Komisioni nuk ka sqaruar se ku qëndrojnë konkretisht të metat e mia dhe si do të duhej që vendimi të ishte hartuar sipas standardeve ligjore. Për sa u përket gjetjeve për moshetimin e plotë të kësaj çështjeje, ky përfundim është nxjerrë nga një keqkuptim i rolit të prokurorisë në një proces penal. Prokuroria nuk ka për detyrë zbardhjen e plotë të ngjarjes së ndodhur (qoftë ajo edhe e dyshuar si penale), por vetëm hetimin e atyre elementeve të rëndësishme që përcaktojnë përgjegjësinë penale. Në rastin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2015, nga ana ime janë kryer të gjitha veprimet që janë vlerësuar si të nevojshme për të përcaktuar nëse kishte ndonjë person përgjegjës penal për shkaktimin e vdekjes së viktimës. Përderisa me provat e marra në këtë hetim ka rezultuar se vdekja e viktimës ka ardhur si rrjedhojë e veprimeve me pakujdesi të vetë viktimës, vijimi i hetimeve në veprimet e sugjeruara nga Komisioni nuk i përket Prokurorisë, pasi nuk ndikon në asnjë mënyrë në këtë procedim penal (hetime të tilla, si leja e zjarrmëtarit, ndërkohë që viktima po punonte si minator, sigurimi i tij apo i punonjësve të tjerë etj.). Sa i përket përfundimit për kryerjen e një akti të ri ekspertimi, Komisioni nuk referon në ndonjë dispozitë ligjore që unë kam shkelur (që parashikon detyrueshmërinë e rikryerjes së një akti të tillë), por mjaftohet me opinionin e tij subjektiv se në rastin në shqyrtim, duhej kryer një akt i ri ekspertimi. Prokurori është drejtues i hetimit penal, por nuk është një institucion që vepron në kundërshtim me parashikimet ligjore procedurale, me qëllim gjetjen dhe sajimin e domosdoshëm të një apo disa personave përgjegjës penalisht, kur ndodhin ngjarje me pasoja në jetën apo shëndetin e njerëzve. Nëse provat janë bindëse dhe të mjaftueshme, këmbëngulja në kryerjen e veprimeve hetimore inproduktive dhe që nuk kanë lidhje me përgjegjësinë penale, janë të gabuara dhe me pasoja në ekonominë kohore të këtij institucioni. Së fundmi, megjithëse ndryshimi i këtij vendimi nga gjykata nuk do të më bënte mua të paafte (pasi çdo prokurori dhe avokati gjykata i rrëzon mijëra kërkesa gjatë karrierës së tij), në rastin në shqyrtim, vendimi i pushimit i marrë nga unë (sipas procedurës së vjetër), nuk është ankimuar fare nga palët, prandaj nuk ka asnjë sens, as bazë ligjore që të diskutohet besueshmëria në ligj dhe në prova të tij. Duke qenë se vepra penale "Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë", parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal do të merret në analizë edhe më poshtë, një analizë teorike parimore më të detajuar mbi elementet e saj konstituiv do ta bëjë në vijim.

26.10 Trupi gjykues, në analizë të të dhënave që i përkasin këtij procedimi, konstaton se: **(i)** procedimi penal nr. {***} i vitit 2015 ka filluar për shkak se në galerinë e minierës që shfrytëzohej nga shoqëria “{***}” ShPK, më datë 06.12.2015, ka gjetur vdekjen punonjësi/minatori i kësaj shoqërie, z. R. A.; **(ii)** pas regjistrimit të këtij procedimi penal është bërë arrestimi në flagrancë i inxhinierit të minierës së shoqërisë “{***}” ShPK, A. H., masë e cila me vendimin nr. {***}, datë 09.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë është zëvendësuar me masën e sigurimit “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”; **(iii)** në relacionin e përfundimit të hetimeve të procedimit penal nr. {***}, të datës 29.12.2015, të hartuar nga Oficeri i Policisë Gjyqësore (OPGj) E. H., konkludohet se instruksionet e gabuara të menaxherit të shoqërisë “{***}” ShPK, z. F. L., kanë passjellë aksidentimin në punë, me pasojë vdekjen e viktimës R. A.²¹. OPGj-ja ka vlerësuar se ka dyshime të arsyeshme dhe prova që shtetasi E. M. dhe F. L. kanë kryer veprën penale “Shkelje e rregullave në punë”, të

²¹ Viktima ka filluar punë si minator zjarrmëtar dhe leja si zjarrmëtar kishte përfunduar më 17.11.2015, pra para datës së aksidentit punë.

parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal; (iv) me vendimin e datës 27.01.2016, subjekti i rivlerësimit Agim Dalipaj ka vendosur “Pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***}, të vitit 2015”, duke argumentuar, ndër të tjera, se në kundërshtim me urdhrin e punës, i ndjeri (viktima) ka shkelur përcaktimet e rregullores teknike të sigurimit në miniera dhe, për pasojë, ndjekja penale ndaj personave për të cilët është regjistruar procedimi penal nr. {***} i vitit 2015, nuk mund të vazhdojë.

26.11 Në kundërshtim të qëndrimeve të Komisionit lidhur me këtë çështje, në ankim, subjekti të rivlerësimit ka shpjeguar se: *Është e vërtetë që urdhri i punës është i plotësuar deri më datë 05.12.2015, ndërsa për ditën e diel, datë 06.12.2015, nuk ka urdhër pune me shkrim, por ai i është dhënë me gojë nga drejtori teknik i shoqërisë A. H., menaxherit të objektit F. L., që ka qenë edhe mbikëqyrës i punimeve*, duke pohuar në fakt një prej konkluzioneve të rëndësishme të arritura prej Komisionit për këtë çështje, pikërisht mungesën e urdhrin të punës që duhet të instruktonte punëmarrësit, përfshi viktimën, për detyrat në ditën e aksidentit. Në këto kushte, subjekti konfirmon pabazueshmërinë e faktit të pranuar në vendimin e pushimit të hetimeve nga vetë ai, se punëtorët për ditën 06.12.2015, kanë pasur urdhrin e punës, dhe duke konfirmuar të kundërtën e asaj që ai ka përdorur si argument për pushimin e hetimeve, se shtetasit A. H., F. L. dhe E. M., duke mos instruktuar punëtorët në ditën e aksidentit, e cila për më tepër ishte ditë e diel, kanë shkelur rregullat e sigurimit në punë, të parashikuara nga neni 289/1 i Kodit Penal. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se me ankimin, subjekti i rivlerësimit nuk u jep përgjigje as mangësive të tjera të evidentuara në vendimin e Komisionit për procedimin penal nr. {***} të vitit 2015, që kanë të bëjnë me skadimin e lejes si minator/zjarrmëtar të viktimës R. A.; dhe as ka mundur të provojë se me hetimet e kryera ka rezultuar që viktima ka qenë i siguruar me policë sigurimi për jetën, apo që ai ka qenë i instruktuar qartë për punën që duhet të kryente dhe rreziqet e saj nga personat përgjegjës të kompanisë minerare për të cilën ai punonte. Nisur nga kjo situatë faktike, të gjitha shpjegimet që subjekti ka dhënë në ankim, përveçse janë një përsëritje e shpjegimeve të tij të dhëna për këtë procedim penal gjatë hetimit administrativ, nuk sjellin asnjë informacion të ri, i cili provon se subjekti ka hetuar në mënyrë të plotë këtë procedim penal se dhe vendimi i pushimit të hetimeve është pasojë e një analize të plotë të situatës faktike dhe të provave të administruara.

26.12 Gjithashtu, nga analiza e akteve të dosjes penale, konstatohet se vendimi pushimit të prokurorit, ndonëse përmban të njëjtat fakte të rezultuara prej hetimit, si ato të përshkruara në relacionin e oficerit të policisë gjyqësore, i cili ka sugjeruar dërgimin e çështjes në gjyq, ka marrë një qëndrim krejt të kundërt për zgjidhjen e çështjes, në mungesë të një analize ligjore mbi to, dhe arsytimit ligjor mbi këndvështrimin e kundërt në vlerësimin e tyre në krahasim me atë të OPGj-së që ka kryer hetimet. Sigurisht që prokurori, duke qenë titullari i hetimeve, nuk ka për detyrë të arsyetojë qëndrimin e kundërt me atë të oficerit, por kjo rrethanë konstatohet në vazhden e problematikës së konstatuar për mungesë të arsytimit të subjektit edhe në dokumentet e tjera ligjore të analizuara më lart, duke sjellë në vëmendje të trupës gjyqësore se kjo qasje nuk është rastësore, por një metodë pune e subjektit të rivlerësimit.

26.13 Nga sa më sipër, trupi gjykues, lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2015, çmon se provat e administruara në fshikullin penal, në asnjë rast nuk mbështesin vendimin për pushimin e hetimeve, duke bërë që të mbetet e paprovuar mungesa e përgjegjësisë së personave nën hetim, për pasojë i gjen pretendimet e subjektit në ankim të pabazuara në fakte e në ligj.

26.14 Në një vështrim përmbledhës dhe në përfundim të analizës së shkaqeve të ankimit që kanë të bëjnë me dosjet penale të zgjedhura me short që i përkasin vendimit, datë 26.01.2015, “Për pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. {***} të vitit 2014” dhe vendimit, datë 27.01.2016, “Për pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2015”, trupi gjykues çmon se problematikat e konstatuara lidhur me to, përfaqësojnë mangësi në hetimet e kryera, mosevidentimin e çdo të dhëne me rëndësi për hetimin dhe që mund të sugjeronte për vijimin me veprime të mëtejshme hetimore në funksion të vënies para përgjegjësisë së autorëve të kryerjes së veprave penale, analiza të munguara të fakteve që kanë rezultuar nga provat e që përbëjnë elementet e veprës penale konkrete, jo në përputhje me strukturën e parashikuar nga dispozitat ligjore. Trupi gjykues vlerësoi se për shkak të mangësive të konstatuara në këto çështje, që duket se tregojnë për mosndërmarrjen logjike të hetimit dhe për cilësi të dobët të analizës dhe argumentimit logjik, me të drejtë Komisioni ka konkluduar se subjekti ka reflektuar njohuri dhe gjykim të dobët, duke afektuar indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

27 Në drejtim të qëndrimit të Komisionit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, marrë pas vlerësimit të çështjeve të tërhequra kryesisht për hetim prej tij, trupi gjykues shqyrtoi edhe pretendimet e subjektit që lidhen me *kundërshtimin e analizës së Komisionit për vendimet e pushimit të procedimeve penale për veprën penale “Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal e të regjistruara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, përkatësisht: (i) procedimi penal nr. {***}; (ii) procedimi penal nr. {***}; (iii) procedimi penal nr. {***}.*

27.1 Në funksion të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues konstaton se pas konstatimit të mangësive të treguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në shqyrtimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2015, Komisioni ka kërkuar nga Prokuroria pranë Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe Lezhë, në të cilat ka ushtuar detyrën subjekti i rivlerësimit, t’i përcjellë këtij organi të gjitha procedimet penale të ndjekura nga subjekti i rivlerësimit për veprën penale të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal, “Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”. Në përgjigje të kësaj kërkesë, këto prokurori i kanë përcjellë Komisionit: (i) procedimin penal nr. {***}, për veprën penale “Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, në ngarkim të shtetasit F. H., me palë të dëmtuar shtetasin N. M., të punësuar në shoqërinë “{***}” ShPK; (ii) procedimin penal nr. {***}, me viktimë shtetasin P. N., në ngarkim të “{***}” ShPK; (iii) procedimin penal nr. {***}, për veprën penale “Shkelje e rregullave të sigurimit teknik në punë”, me pasojë tri viktima, në ngarkim të shoqërisë ndërtuese të HEC-it të {***}-ut.

27.2 Në vendimin e Komisionit për procedimin penal nr. {***}, për veprën penale “Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, në ngarkim të shtetasve F. H., është konkluduar sa vijon: *Komisioni çmon se në lidhje me këtë dosje penale, duke marrë në konsideratë faktin se kishim të bënim edhe me një të plagosur rëndë, subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi, njohuri dhe gjykim të dobët, pasi evidentohet se: (i) subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të cilësuara më lart, në këto rrethana, kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht shkaqet e aksidentit, subjekti duhej të vazhdonte hetimet dhe pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes; (ii) subjekti nuk analizon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme elementet e veprës penale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë; (iii) vendimi i pushimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jobindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështetet në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk*

gjejnë pasqyrim në dosje, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

27.3 Në ankim, subjekti i rivlerësimit, lidhur me këto konkluzione të Komisionit, pretendon se: *Më datën 23.6.2009, kam vendosur pushimin e procedimit penal nr. {***}, për veprën penale "Shkelje e rregullave të sigurimit teknik në punë", parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal, duke konstatuar se nuk ka shkelje të rregullave të sigurimit teknik nga shtetasi F. H., por janë pakujdesia dhe shkeljet e bëra nga i dëmtuari N. M., ato që kanë sjellë pasojën e plagosjes së rëndë të këtij shtetasi. Ky vendim është shfuqizuar nga prokurori i rrethit në datën 14.7.2009. Pasi kam administruar dëshminë e aftësisë së shtetasit F. H. dhe aktekspertimin e kryer nga eksperti G. C., kam vendosur sërish pushimin e procedimit penal në fjalë. Edhe për këtë akt, nga Komisioni pasqyrohet literalisht njësoj i njëjti përfundim si për aktet e tjera, se edhe në këtë vendim nuk janë parashtruar në mënyrë të qartë rrethanat konkrete të faktit, pasi unë i kam kushtuar më tepër rëndësi citimit të deklarimeve të personave që kanë dijeni për veprën penale, duke anashkaluar paraqitjen e hollësishme dhe qartësisht të kuptueshme të rrethanave të faktit. Gjithashtu, përsëritet e njëjta tipologji, gjetjet si më lart, se vendimi mbështetet në rrethana fakti të verifikuara pjesërisht dhe në mungesë të kryerjes së të gjitha veprimeve të nevojshme hetimore për të arritur në një konkluzion të drejtë mbi ekzistencën ose jo të elementeve të veprës penale. [...]*

27.4 Trupi gjykues, në analizë të akteve të fashikullit të procedimit penal nr. {***} të vitit 2009, të administruar nga Komisioni, vëren se përmbajtja e vendimit të pushimit të hetimeve të datës 23.06.2009, evidenton se subjekti i rivlerësimit nuk referon në mënyrë të plotë situatën faktike rreth marrëdhënies së personit nën hetim F. H. dhe të dëmtuarit N. M. (nëse kemi të bëjmë me një marrëdhënie punësimi te kompania “{***}” ShPK apo ndonjë marrëdhënie tjetër); nuk dokumenton pasjen e lejeve të drejtimit të mjeteve të rënda nga personi nën hetim dhe as instruktimin e tij për rregullat e përdorimit të mjeteve në kantier, me anë të të cilave do të mund të provohej se ishte i aftë për të drejtuar mjetet dhe se i ishin vënë në dijeni pasojat që kishte pakujdesia në punën që ai kryente. Referuar përmbajtjes së vendimit të pushimit të hetimeve, rezulton se të gjitha konkluzionet e subjektit që e kanë çuar atë drejt arritjes së përfundimit se personi nën hetim nuk ka kryer shkelje të rregullave teknike në punë sipas nenit 289 të Kodit Penal, bazohen në deklaratimet e personit drejtues teknik të kompanisë “{***}” ShPK, dhe jo në dokumente apo akte që i faktojnë ato. Lidhur me personin e dëmtuar N. M., subjekti i rivlerësimit, në vendimin e pushimit të hetimeve, nuk jep asnjë informacion mbi prezencën e tij në kantierin e ndërtimit, nëse ai ishte si i punësuar apo ishte një person i rastësishëm, dhe nëse është kjo e fundit si justifikohet prezenca e tij në një kantier pune. Gjithashtu, rezulton se drejtuesi i prokurorisë, me vendimin e datës 14.07.2009, ka shfuqizuar vendimin e subjektit të rivlerësimit për pushimin e hetimit të këtij procedimi, duke renditur një sërë veprimesh hetimore që nuk janë kryer nga subjekti i rivlerësimit në hetimin e këtij procedimi, si: (i) mosadministrimi i automjetit të drejtuar nga F. H.; (ii) mosadministrimi i lejes së drejtimit të F. H. dhe mosverifikimi se ka kryer një kurs trajnimit për drejtimin e mjeteve të rënda.

27.5 Nisur nga sa përshkruar më sipër, trupi gjykues çmon se rezulton e qartë se vendimi i pushimit të hetimeve për procedimin {***} nga subjekti i rivlerësimit, mbi të gjitha është marrë pa kryer një hetim të plotë lidhur me aksidentimin e rëndë të shtetasit N. M., pa arritur të sqarojë një fakt me rëndësi, si ai që lidhet me dëshminë e aftësisë së manovratorit që ka shkaktuar

dëmtimin për të drejtuar një mjet të rëndë pune, element që do të duhej të ndikonte drejtpërdrejt në përcaktimin e përgjegjësisë penale dhe personave përgjegjës. Në vendimin e pushimit, konstatohet gjithashtu mungesë e analizës së fakteve që kanë rezultuar nga hetimi nën dritën e parashikimeve ligjore që rregullojnë përgjegjësinë për respektimin e rregullave të mbrojtjes në punë. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit në ankim, lidhur me konkluzionet e Komisionit për këtë procedim, mbeten të paargumentuara dhe, si të tilla, ato nuk paraqesin elemente që mund të ndryshojnë këto konkluzione.

27.6 Në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit me anë të të cilave ai kundërshton konkluzionet e Komisionit lidhur me procedimin penal nr. {***} të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me të dëmtuar shtetasin P. N., të punësuar pranë kompanisë “{***}” ShPK, trupi gjykues konstaton dhe analizon sa vijon.

27.7 Në vendimin e Komisionit për procedimin penal {***}, është konkluduar se: *Subjekti ka vendosur në datën 4.4.2019, mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. {***}, pasi fakti nuk parashikohet në ligj si vepër penale ose fakti nuk ekziston. Nga verifikimi i fashikullit penal, rezulton se: (i) subjekti nuk ka administruar aktin e ekspertimit mjeko-ligjor. Në dosje gjendet shkresa nr. {***} regj., datë 10.4.2019, e IML-së (pra, pas vendimit të mosfillimit), ku i kërkohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, dërgimi i gjeneraliteteve të plota të shtetasit P. N.; (ii) subjekti nuk ka administruar aktekspertimin teknik në lidhje me aksidentin e ndodhur; (iii) nga aktet e dosjes, nuk rezulton të jenë sqaruar detyrimet që ka punëdhënësi. Konkretisht, nuk është sqaruar nëse nga punëdhënësi janë marrë masat e nevojshme të sigurimit teknik për shmangien e aksidenteve dhe ngjarjeve që cenojnë jetën dhe shëndetin e punonjësve, dhe nuk është sqaruar nëse i dëmtuari ka qenë i instruktuar; (iv) subjekti nuk ka rezultuar të jetë hetuar në lidhje me pajisjen e shoqërisë me të gjitha lejet/licencat/autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit; (v) subjekti nuk ka administruar kontratën e punës së të dëmtuarit. [...]*

Komisioni, pasi analizo shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti nuk mund të vendoste mosfillimin e procedimit pa administruar aktin e ekspertimit mjeko-ligjor, si dhe kryerjen e një ekspertimi teknik në lidhje me aksidentin e ndodhur. Nga aktet e dosjes, nuk rezulton të jenë sqaruar detyrimet që ka punëdhënësi. Konkretisht: (i) nuk është sqaruar nëse nga punëdhënësi janë marrë masat e nevojshme të sigurimit teknik për shmangien e aksidenteve dhe ngjarjeve që cenojnë jetën dhe shëndetin e punonjësve; (ii) nuk është sqaruar nëse i dëmtuari ka qenë i instruktuar. Nga subjekti nuk rezulton të jetë hetuar në lidhje me pajisjen e shoqërisë me të gjitha lejet/licencat/autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit. Komisioni çmon se në lidhje me këtë dosje penale, duke marrë në konsideratë edhe faktin që kishim të bënim me një të plagosur rëndë, por në mungesë të një aktekspertimi mjeko-ligjor për të përcaktuar shkallën e dëmtimit, subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi, njohuri dhe gjykim të dobët, pasi evidentohet se: (i) subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të cilësuarat më lart, në këto rrethana, kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht shkaqet e aksidentit, subjekti duhej të vazhdonte hetimet dhe pasi të kryeshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes; (ii) subjekti nuk analizon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme elementet e veprës penale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë; (iii) vendimi i mosfillimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jobindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështeten në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët

e parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

27.8 Në ankim, subjekti kundërshton konkluzionet e mësipërme të vendimit të Komisionit për procedimin penal {***}, duke pretenduar se: *Pas kalimit të barrës së provës, kam sqaruar se mbi bazën e materialit kallëzues të ardhur nga Komisariati i Policisë Lezhë në prokurori, në datën 20.3.2019, pasi kam studiuar materialin dhe kam konstatuar se i dëmtuari ishte i siguruar te lista e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi, me NIPT {***}, për muajin shkurt të vitit 2019, kam vërejtur se në numrin rendor 6 ishte emri i tij, si dhe në deklaratën e datës 15.3.2019, të lëshuar nga i dëmtuari, ku thuhet se për datën 14.3.2019 (ditë feste zyrtare), një pjesë e punëtorëve, duke përfshirë edhe atë, kanë rënë dakord që të punonin dhe i kanë thënë pronarit të shkonin në punë sepse kishin interes, pasi dita e punës ishte 50% më e lartë [...] dhe nga ora 9 kur po pastronte gaterrin, rrëshqiti dhe ra me shpinë. Ka theksuar se ka qenë një pakujdesi e tij që ka rrëshqitur dhe se nuk ka pretendime të tjera. Kam pritur ardhjen e përgjigjes së aktekspertimit, e cila nuk erdhi brenda 14 ditëve dhe meqenëse afati për regjistrimin e procedimit penal është 15 ditë, në datën 4.4.2019, kam vendosur mosfillimin e procedimit penal, që fakti nuk parashikohet në ligj si vepër penale dhe e kam dërguar dosjen për qepje dhe arshivim. Në momentin që m'u kërkua sqarim nga KPK-ja, kam shkuar në prokurori dhe e kërkova këtë material, ku konstatova se në dosjen e këtij mosfillimi, ndodhej një shkresë e IML-së Tiranë, që mbante datën 10.4.2019, e cila kërkonte saktësimin e gjeneraliteteve të shtetasit P. N., pasi me këtë emër dhe mbiemër janë dy persona. Gjithashtu, në datën 16.4.2019, kishte ardhur edhe një dëshmi mjeko-ligjore e ekspertit mjeko-ligjor Lezhë, i cili thoshte se nuk mund ta bëjë këtë aktekspertim, pasi i dëmtuari ka shkuar në Tiranë dhe duhet ta kërkonin atje. Me të dyja këto shkresa, nuk është njohur më parë. [...] Në rastin e çështjes konkrete, vetë i dëmtuari ka shpjeguar se ka rrëshqitur nga pakujdesia dhe nuk ka pasur asnjë pretendim për ngjarjen. Nga ana tjetër, vendimi i mosfillimit nuk është ankuar në gjykatë, prandaj të cilësohem si i paaftë për një qëndrim të tillë, është thjesht një përfundim tendencioz subjektiv, që s'ka të bëjë as me nevojën për të dhënë drejtësi, as për profesionalizëm.*

27.9 Nga analizimi i akteve të fashikullit penal të kësaj çështjeje, rezulton se:

(i) Vendimi për mosfillimin e procedimit penal të datës 04.04.2019, i marrë nga subjekti i rivlerësimit, bazohet në deklaratimet e palës së dëmtuar P. N., si dhe në deklaratimet e disa punonjësve të tjerë. Subjekti i rivlerësimit nuk ka hetuar se në cilin pozicion pune ishte i punësuar i dëmtuari pranë shoqërisë “{***}” ShPK. Mungesa e kontratës së punës mes shoqërisë dhe punëtorit të dëmtuar, tek e cila janë përcaktuar detyrat e tij si i punësuar, si dhe moskryerja e asnjë hetimi rreth faktit nëse shoqëria ka instruktuar punëtorët për rreziqet në punë, duken si elemente që kanë mundësuar shmangien nga përgjegjësia penale e drejtuesve të kompanisë tek e cila ishte i punësuar i dëmtuari.

(ii) Mungesa e aktit të ekspertimit mjeko-ligjor të të dëmtuarit P. N. (i cili është kërkuar të kryhet nga OPGj-ja më datë 14.03.2019), në momentin e marrjes së vendimit për mosfillimin e procedimit penal, më datë 04.04.2019, duket sikur shkon në favor të minimizimit të pasojave të kësaj ngjarjeje dhe krijon pamundësi për një kualifikim të saktë të fakteve në drejtimin e përgjegjësisë penale.

27.10 Nga sa më sipër, trupi gjykues çmon se marrja nga subjekti i rivlerësimit, e vendimit për mosfillim të procedimit penal më datë 04.04.2019, për çështjen {***}, kur vetë ai nuk ka

administruar rezultatet e verifikimeve të kërkuara/iniciuara prej tij, si dhe moskryerja e asnjë hetimi për respektimin nga kompania të rregullave të sigurisë në punë, janë elemente të mjaftueshme për të konkluduar që në shqyrtimin e kësaj çështjeje, subjekti ka shfaqur mangësi të theksuara në kryerjen e detyrave të prokurorit për hetimin e çështjes, të cilat me të drejtë kanë ndikuar në vlerësimin që Komisioni ka kryer për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues vëren se këto mangësi konstatohet se janë pothuajse të njëjta, në të gjitha çështjet e analizuara më sipër, që lidhen me hetimin e veprës penale të “Shkeljes së rregullave teknike në punë”, të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal.

27.11 Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, me të cilat ai kundërshton konkluzionet e Komisionit lidhur me procedimin penal nr. {***} të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me pasojë tri viktime, trupi gjykues konstaton dhe analizon sa vijon.

27.12 Në vendimin e Komisionit për procedimin penal 839/2014, është konkluduar se: Komisioni vlerëson gjithashtu se subjekti, duke marrë në konsideratë edhe faktin që kishim të bënim me tri viktime, si dhe bazuar në dinamikën e ngjarjes, duhej të kishte kërkuar kryerjen e një akti riekspertimi teknik me grup ekspertësh, pasi aktekspertimi teknik, ku mbështetet vendimi i pushimit të çështjes, nuk përmban të gjitha elementet që duhet të ketë një akt i tillë, në funksion të sqarimit të rrethanave të ngjarjes dhe shkaqeve të ndodhjes së saj. Nga ana e tij, nuk është administruar në dosje polica e sigurimit nga aksidentet personale të punonjësve, si dhe i gjithë dokumentacioni i shoqërisë për të vërtetuar nëse kjo e fundit po kryente veprimtari konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Fakti se kjo shoqëri kishte lidhur një kontratë koncensionare, nuk e përjashton nga detyrimi për t’u pajisur me të gjitha lejet/licencat/autorizimet e nevojshme për të ushtruar veprimtarinë konform legjislacionit në fuqi. Në dosje nuk ndodhet dhe urdhri i punës i datës së ndodhjes së aksidentit. Komisioni çmon se duke marrë në konsideratë edhe faktin se tre punonjës kishin humbur jetën, subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi, njohuri dhe gjykim të dobët, pasi evidentohet se: (i) subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të cilësuar më lart, në këto rrethana, kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht shkaqet e aksidentit, subjekti duhej të vazhdonte hetimet dhe, pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes; (ii) subjekti nuk analizon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme elementet e veprës penale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë; (iii) vendimi i mosfillimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jobindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështetet në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

27.13 Në ankim, lidhur me konkluzionet e Komisionit për këtë procedim, subjekti i rivlerësimit në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar sa vijon: [...] Ky procedim penal është filluar më datë 01.08.2014 dhe është pushuar më 10.11.2014. Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Lezhë, më datë 15.12.2014, ka prishur këtë vendim dhe ka caktuar për hetimin e kësaj çështjeje Y. P., dhe pas komandimit të tij në Tiranë, kjo dosje i ka kaluar prokurorit B. Ll., i cili, më datë 30.07.2018, ka vendosur pezullimin e hetimit për shkak të letërporosisë së dërguar në shtetin turk, deri në ardhjen e përgjigjes. Përfundimisht, sqaroj se kam arsyetuar dhe argumentuar të gjitha veprimet hetimore konform ligjit në kohën që është marrë vendimi i pushimit. Gjithashtu, duhet të mbahet në konsideratë se Komisioni është shprehur për një çështje penale e cila është në hetim dhe akoma nuk ka përfunduar. [...]

Sa i përket vendimit të titullarit për të shfuqizuar vendimin tim dhe urdhëruar kryerjen e një akti të ri ekspertimi, ky është një proces normal ligjor që atij ia ka njohur ligji (në kohën kur e ka marrë), por kjo nuk e bën sjelljen time si të paaftë, pasi nuk ka asnjë prokuror të cilit titullari nuk i ka prishur vendime të marra prej tij. Në fund të fundit, edhe titullari është një individ me formimin dhe bindjet e tij subjektive dhe, nëse unë dhe ai do të kishim ndërruar pozicionet e punës, kjo nuk do ta bënte qëndrimin tim më të drejtë dhe të tijin më të gabuar.

27.14 Nga analiza e akteve të hetimit penal të kësaj çështjeje, konstatohet se: **(i)** me vendimin e datës 10.11.2014, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2014; **(ii)** me vendimin e datës 15.12.2014, drejtuesi i prokurorisë ka vendosur shfuqizimin e vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, datë 10.11.2014, për pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2014, me arsyetimin se vendimi i pushimit është marrë duke u bazuar në një akt ekspertimi jo të plotë dhe të qartë për të përcaktuar se cili ka qenë shkaku i aksidentit nga i cili kanë humbur jetën tre shtetas, duke konsideruar se qëndrimi i prokurorit të çështjes, se kemi të bëjmë me një rast fatkeq, rezulton i pabazuar, si edhe ka zëvendësuar subjektin e rivlerësimit si prokuror i çështjes me një prokuror tjetër; **(iii)** me vendimin e datës 27.07.2016, prokurori zëvendësues i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka marrë vendimin për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***} të vitit 2014; **(iv)** ky vendimin është ankimuar në gjykatë nga një nga familjarët e viktimave të këtij procedimi, z. P. D., me anë të të cilit ankuesi kundërshton vendimin e datës 27.07.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***} të vitit 2014. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. {***}, datë 21.02.2017, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit të datës 27.07.2016. Kjo gjykatë në këtë vendim ka arsyetuar se nga organi i akuzës duhen kryer disa veprime hetimore pasi kanë lindur dyshime se nga shoqëria për të cilën punonin viktimat, nuk janë respektuar rregullat e sigurimit teknik gjatë punës; **(v)** bazuar në këtë vendim, prokurori i çështjes, më datë 23.03.2018, ka vendosur pezullimin e hetimeve dhe ka kërkuar ndihmë juridike nga organet kompetente të shtetit turk, për t'i mundësuar këtij organi marrjen në pyetje të disa shtetasve të punësuar pranë kompanisë turke “ {***}”, që po ndërtonte hec-in tek i cili humbën jetën viktimat; **(vi)** aktualisht, kjo çështje është ende në statusin “e pezulluar”.

27.15 Trupi gjykues, nga analizimi i vendimit të pushimit të procedimit penal nr. {***} të vitit 2014, të hartuar nga subjekti i rivlerësimit, për sa i përket strukturës së tij, vëren të njëjtat mangësi me ato të evidentuara më sipër për veprat penale të hetuara prej tij për “Shkelje të rregullave të mbrojtjes në punë”, të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal. Edhe në këtë vendim pushimi të çështjes penale, jepen dëshmitë e dëshmitarëve, por nuk evidentohen aktet e tjera të marra në cilësinë e provës dhe as ka një analizë të tyre. Konstatohet se në të, referohen pjesë nga akti i ekspertimit të cilat nuk hedhin dritë mbi veprimet e viktimave dhe nuk ndihmojnë në kuptimin e zgjidhjes së çështjes. Përndryshe në akt, nuk referohet rreth instruktimit të viktimave për detyrat që kishin, urdhrat e punës për të përcaktuar zonën që është shembur, si një vend ku duhej të punohej apo nëse viktimat janë postuar aty me iniciativë të tyre. Në këtë vendim gjithashtu mungon një përshkrim i statusit ligjor dhe i lejeve dhe licencave që dispononte shoqëria për të cilën punonin viktimat. Trupi gjykues vlerësoi se, edhe fakti që kjo çështje aktualisht është pezulluar për shkak se pritet që organet kompetente turke t'i mundësojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, marrjen në pyetje të disa punonjësve të kompanisë turke që ndërtonte Hec-in e {***}-ut, të cilët ka qenë e pamundur të pyeten për shkak

të largimit të tyre nga Shqipëria, duket se është i lidhur me mungesën e kryerjes së veprimeve hetimore (pyetjes së tyre) afër kohës së ngjarjes, e cila tregon sërish për mangësi të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

27.16 Në përfundim të analizës për çështjet e analizuara nga Komisioni që kanë të bëjnë me pushimin e procedimeve penale për veprën penale “Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal e të regjistruara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, përkatësisht: (i) procedimi penal nr. {***}; (ii) procedimi penal nr. {***}; (iii) procedimi penal nr. {***}, rezultojnë se përfaqësojnë tipologji të njëjtë në drejtim të vlerësimit dhe ndërmarrjes së hetimit, me neglizhencë dhe pa angazhimin e duhur profesional, e cila ka diktuar përgjithësisht, së bashku me zgjidhjen e çështjes nr. {***} të cituar më lart, në shkeljen e të drejtave të qytetarëve kundrejt personave të cilët dyshohej se kishin kryer shkeljet e ligjit me pasojë dëmtimin e shëndetit dhe jetës së tyre. Parë nën këtë këndvështrim, trupi gjykues vlerëson se i gjithë arsyetimi i Komisionit që përfshin konkluzionin se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, për shkak të trajtimit të këtyre shkeljeve, duhet të trajtohet si i kualifikuar/përfshirë nën indikatorin e etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, sipas parashikimit të nenit 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, krahas mangësive sipas nenit 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016. Cenimi i besimit te sistemi i drejtësisë në këtë rast, vlerësohet se ka ndodhur dhe duhet të përfshihet brenda indikatorëve të aftësive profesionale.

28 Trupi gjykues mori në analizë edhe pretendimet e paraqitura në ankim nga subjekti i rivlerësimit lidhur me denoncimin e paraqitur nga shtetasi L. P., për të cilat konstatoi dhe analizoi sa vijon.

28.1 Në vendimin e Komisionit, lidhur me denoncimin e shtetasit L. P. është konkluduar se: *Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore [...] Komisioni, duke analizuar vendimet e gjykatës të vëna në dispozicion nga ankuesi, i ka kaluar subjektit barrën e provës, si vijon: Kërkesa për pushimin e procedimit penal nr. {***}, nuk është rezultat i një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, pasi subjekti: (i) nuk ka argumentuar hollësisht përse fakti nuk përbën vepër penale, por është çështje civile; (ii) shprehet se fakti që ka rezultuar gjatë hetimeve, nuk përbën vepër penale pa analizuar në përputhje me provat e administruara dhe hetimet që janë kryer deri në ato momente; (iii) nuk ka bërë asnjë lloj hetimi apo verifikimi për shpalljen e pavlefshme nga Gjykata e Lartë të kontratës së shitjes nr. {***}, datë 9.11.2010; (iv) nuk ka kryer një hetim të plotë në lidhje me mënyrën e përfitimit të pronësisë nga shtetasi Gj. N. mbi pasurinë e paluajtshme nr. {***} dhe ekzistencën e kontratës së shitjes nr. {***}, datë 9.11.2010, lidhur midis tij dhe Bashkisë Lezhë; v) është bazuar në deklarinimin e personave pa administruar të gjithë dosjen e Bashkisë Lezhë që ka vendosur miratimin e lejes së ndërtimit për shtetasin Gj. N. dhe dosjen pranë ZVRPP-së Lezhë, si dhe nuk ka marrë informacion në lidhje me mënyrën e përfitimi të pasurisë nr. {***} nga shtetasi Gj. N.; (vi) nuk ka kërkuar kryerjen e një ekspertimi topografik për të përcaktuar nëse ndërtimi po kryhet apo jo në përputhje me lejen zhvillimore të ndërtimit nr. {***} prot., datë 5.8.2015; (vii) nuk ka administruar dosjen gjyqësore civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë në lidhje me vendimin nr. {***}, datë 20.10.2017.*

*Subjekti nuk ka zbatuar afatet e përcaktuara nga gjykata në vendimin nr. {***}, datë 23.3.2018, duke zvarritur procedimin penal përtej afatit 60-ditor të caktuar nga gjykata, si dhe nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore të kërkuara nga gjykata, duke vepruar në kundërshtim me nenin 329/3, germa “b” e Kodit të Procedurës Penale. [...] Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Bazuar në provat e*

depozituara nga subjekti, procedimi i ka kaluar sërish këtij të fundit në datën 24.10.2018 dhe kërkesa për pushim është depozituar prej tij në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë në datën 13.12.2018, pra, brenda afatit 60-ditor të përcaktuar nga gjykata. Por, pavarësisht këtij fakti, nga subjekti nuk rezulton të jenë zbatuar detyrimet e përcaktuara nga gjykata, të cilat kanë sjellë si pasojë edhe kthimin e akteve. Komisioni çmon se në lidhje me këtë dosje penale, subjekti ka treguar aftësi, njohuri dhe gjykim të dobët, pasi evidentohen: (i) mangësi në drejtim të hetimit të plotë të çështjes dhe hetim i dobët nga subjekti; (ii) subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore të kërkuara nga gjykata, duke vepruar në kundërshtim me nenin 329/3, germa "b" e Kodit të Procedurës Penale, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pika 2 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

28.2 Në ankim lidhur me qëndrimin e Komisionit për këtë çështje, subjekti parashtron se: [...] për kohën e shkurtër që e kam pasur këtë çështje, unë kam kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, por edhe me veprimet (sipas meje të panevojshme) që ka urdhëruar gjykata, nuk mund të ndryshojë asgjë në fatet e këtij procedimi penal. Prokuroria dhe gjykata penale nuk mund të zgjidhin konfliktet civile mes qytetarëve, por ka për detyrë që të hetojë vetëm kryerjen e veprave penale të caktuara. Në rastin konkret, hetimet për veprën penale për të cilën janë filluar hetimet, "Ndërtim i paligjshëm", kanë qenë të plota dhe shteruese, pasi shtetasi Gj. N. është i pajisur me një leje të rregullt ndërtimi, të lëshuar sipas ligjit nga organet e pushtetit vendor, ndërkohë që zgjidhja e konfliktit civil për pronësinë e truallit mes denoncuesve dhe atij (për pavlefshmërinë e kontratës së blerjes së truallit) duhet të bëhet me një padi civile drejtuar gjykatës civile (siç është bërë dhe është gjykuar edhe në apel). Komisioni nuk ka sqaruar se cilat veprime hetimore nuk kam kryer unë gjatë periudhës së shkurtër që e kam pasur këtë procedim dhe hetimit të cilës veprë penale do t'i ndihmonte ajo. Vioj të përsëris se thellimi i hetimeve në fusha të cilat nuk janë objekt i veprimtarisë kushtetuese dhe ligjore të Prokurorisë, përbën shpërdorim të burimeve njerëzore dhe ekonomike të këtij institucioni dhe do të duhej të ishte vlerësuar nga Komisioni si paaftësi dhe shkelje në punë dhe jo e kundërta. Nga ana tjetër, edhe sikur të vlerësohet i drejtë vendimi i gjykatës për kthimin e akteve në hetim, kjo nuk përbën cilësi të dobët pune për mua, pasi kjo është arsyeja e ngritjes së filtrit gjyqësor për vendimet e pushimit që të kontrollohen më mirë nga gjykata.

28.3 Nga leximi i shpjegimeve dhe ankimit të subjekti lidhur me trajtimin e këtij denoncimi, vihet re se ndërsa pohon faktin që gjykata i ka prishur vendimin e pushimit të hetimeve të procedimit nr. {***} të vitit 2018, të ndjekur prej tij, konfirmon gjithashtu se ai ka kryer veprime hetimore shtesë të përcaktuara prej saj, të cilat pavarësisht që nuk e kanë çuar atë në një vendimmarrje të ndryshme, pasi sërish ai në përfundim të hetimeve, ka vendosur pushimin e çështjes, që sërish është prishur nga gjykata. Ndërsa parashtron panoramën e fakteve, subjekti në asnjë moment nuk shpjegon dhe argumenton përse nga ana e tij nuk ishin kryer hetimet e përcaktuara nga gjykata në të dyja vendimet që prishin vendimet për pushimin e çështjes. Argumenti i përdorur se kjo situatë shoqëron punën e të gjithë prokurorëve, nuk mund të shmangë konstatimet që trupi gjykues bën në këtë rast për hetime të paplota, dhe mangësi në drejtim të aftësive profesionale të subjektit, të cilat duket se janë konstatuar radhazi edhe nga kontrolli gjyqësor.

28.4 Trupi gjykues lidhur me këtë situatë, duke konsideruar faktin që mungesa e hetimeve të plota është një fenomen i hasur në të gjitha çështjet e trajtuara më sipër, të cilat janë hetuar prej

subjektit të rivlerësimit, çmon se duhet vlerësuar së bashku me rastet dhe konkluzionet e tjera, të cilat tregojnë për neglizhencë dhe mangësi në punën e subjektit si prokuror, në funksion të kryerjes së hetimeve të plota të çështjeve të cilat kanë passjellë si pasojë, vonesa në zgjidhjen e tyre, pra kanë shkaktuar një drejtësi të vonuar, ndoshta edhe të munguar për qytetarët.

28.5 Në përfundim, lidhur me denoncimin e shtetasit L. P., në analizë të të cilit u morën në shqyrtim sjellja e prokurorit kundrejt detyrimeve që burojnë nga vendimet e gjykatës në rolin e organit kontrollues të veprimtarisë hetimore të prokurorit, trupi gjykues konkludoi se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, pa arsye dhe në kundërshtim me detyrimet që vijnë nga ligji, përveç se nuk ka ndërmarrë logjikshëm hetimin, ka shmangur edhe zbatimin e detyrimeve që vijnë nga vendimet gjyqësore, për të përmbyllur hetimin në mënyrë të plotë. Kjo sjellje, me të drejtë është konsideruar nga Komisioni se ka afektuar indikatorin e parashikuar nga nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

- 29** Në përfundim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues konkludon se shkeljet dhe mangësitë e evidentuara, të cilat paraqiten jo në mënyrë të veçuar, por si një tipologji çështjesh të trajtuara në seri me mangësi në kryerjen e hetimeve, në analizimin e veprës penale, si dhe në argumentimin e vendimeve të dhëna, janë situata që me të drejtë nga Komisioni janë konsideruar se e klasifikojnë subjektin e rivlerësimit si të papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale në zbatim të nenit 44, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016 e, për pasojë, nën parashikimin e nenit 61, pika 4 e këtij ligji.
- 30** Në kushtet kur konstatohet se për të njëjtat shkaqe e rrethana, për të cilat subjekti është gjendur nën parashikimet e nenit 61, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka konkluduar se ai duhet të përgjigjet edhe sipas nenit 61, pika 5 e këtij ligji, trupi gjykues vlerëson si të pambështetur ligjërisht këtë konkluzion, përderisa ai kualifikon në mënyrë të përsëritur të njëjtat shkaqe shkarkimi, të cilat janë kualifikuar sipas përcaktimeve të pikave më lart, brenda së njëjtës dispozitë. Në vijim të jurisprudencës së tij tashmë të konsoliduar në këtë drejtim, Kolegji e gjen të pambështetur dhe të panevojshëm aplikimin e pikës 5 të nenit 61 në rastin objekt shqyrtimi.
- 31** Trupi gjykues, ndonëse gjeti të drejta disa nga shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, i vlerësoi ato të pamjaftueshme për të ndryshuar vendimin objekt shqyrtimi.
- 32** Në vlerësim dhe analizë të konkluzioneve të mësipërme, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, i gjendur në situatat e mësipërme të shkeljes së ligjit, nuk arrin të përmbushë kriteret kushtetuese për arritjen e një niveli të besueshëm në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, sipas kërkesave të nenit D, pikat 1, 3 e 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe rezulton me mangësi nga vlerësimi i aftësive profesionale, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës. Për pasojë, trupi gjykues çmon se konkluzionet e mësipërme e vendosin subjektin në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm të pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe e klasifikojnë atë si të papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale, sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke përcaktuar për pasojë, në mënyrë detyruese, zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit të tij nga detyra. Për pasojë, vendimi nr. 402, datë 17.06.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është marrë mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi vendimit nr. 402, datë 17.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Agim Dalipaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 13.07.2023

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi